

Qendra për Mbrojtjen dhe Studimin e Shpendëve

Dr. Martin Schneider – Jacoby Association

Plani strategjik i veprimit për zbatimin e sistemeve ushqimore të qëndrueshme dhe të arsyeshme në zonën e Ulqinit 2023-2025

Podgoricë, tetor 2022



Ky dokument është krijuar në kuadër të projektit *Foodnected*, i zbatuar në Mal të Zi nga Qendra për Mbrojtjen dhe Studimin e Shpendëve (CZIP) dhe Dr. Martin Schneider – Jacoby Association (MSJA), në bashkëpunim me partnerët *Slow Food*, *Global Footprint Network*, *GOB Menorca*, *Low Impact Fishers of Europe*, *Aleance for Mediterranean Nature and Culture* dhe *Yolda*. Projekti *Foodnected* mbështetet nga Fondacioni MAVA. Qëllimi i këtij dokumenti është zbatimi i konceptit të *Slow food* në komunën e Ulqinit në tre vitet e ardhshme dhe bazohet në një analizë të detajuar të gjendjes së bujqësisë dhe prodhimit të ushqimit në zonën e Ulqinit, duke përfshirë analizën e produkteve dhe recetave tradicionale.

Botuesi i dokumentit: Qendra për Mbrojtjen dhe Studimin e Shpendëve dhe Dr. Martin Schneider – Jacoby Association (MSJA)

Teksti: Sabina Ramović, *Slow food* Montenegro – Bjelasica, Komi dhe Bjeshkët e Nemuna

Shtyp: AP Print d. o. o.

Përktheu: Bernard Çobaj

Redaktimi: Agjencia „Lektura“

Podgoricë, tetor 2022

Financuar nga:



Përmbajtja:

1.	HYRJE.....	5
1.2	Qëllimi i përgjithshëm.....	8
1.2	Kuadri ligjor	9
2.	BAZA NATYRORE DHE SHOQËRORE E BUJQËSISË NË ULQIN.....	9
2.1	Pozita gjeografike.....	9
2.2	Klima	10
2.3	Lumenjtë	10
2.4	Liqenet.....	11
2.5	Deti.....	11
2.6	Toka	11
2.7	Të dhënat demografike	12
2.8	Struktura moshore e popullsisë.....	13
2.9	Punësimi	13
2.10	Kultura	14
2.11	Turizmi në zonat rurale	16
2.12	Zonat rurale	17
3.	ZHVILLIMI DHE GJENDJA E BUJQËSISË NË ULQIN	Error! Bookmark not defined.
3.1	Të dhënat e disponueshme dhe infrastruktura e qeverisjes lokale	18
3.2	Regjistri i njësive bujqësore (RNJB)	20
3.3	Sektori i bujqësisë.....	24
3.3.1	Toka bujqësore	24
3.3.2	Blegtoria.....	27
3.3.3	Prodhimi bimorë.....	28
3.3.4	Pemëtaria dhe perimet	28
3.3.5	Ekonomi bujqësore	29
3.3.6	Ullishtaria	29
3.3.7	Vreshtaria.....	30
3.3.8	Peshkataria.....	31
4.	SWOT ANALIZA E SEKTORIT TË BUJQËSISË.....	34
5.	PRODHIMI TRADICIONAL DHE ORGANIK	37
5.1	Produkte tradicionale, gjeografikisht të njohura dhe cilësore	37
5.2	Prodhimtaria organike.....	42
6.	KORNIZA INSTITUCIONALE QË NDIKON DREJTPËRDREJT NE ZHVILLIMIN E SEKTORIT	43
7.	MASAT MBËSHTETËSE NË NIVEL SHTETORË.....	45

8. KONKLuzionet, Vizioni, Qëllimet Strategjike, Fushat Prioritare të Ndërhyrjes, Masat, Plani i Veprimit dhe Programet Zhvillimore.....	49
8.1 Vizioni	52
8.2 Prioritetet strategjike	52
8.2.1. <i>Ndërtimi i një mjedisi institucional që inkurajon përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat rurale dhe krijimin e kushteve për kthimin dhe mbajtjen e popullsisë në zonat rurale</i>	53
8.2.2 <i>Rritja e vëllimit dhe konkurrueshmërisë së sektorëve prioritarë të bujqësisë në zonat rurale (aktivitetet e prodhimit, përpunimit dhe shërbimeve)</i>	54
8.2.3 <i>Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore</i>	55
8.2.4 <i>Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, ruajtja dhe mbrojtja e natyrës dhe e mjedisit;</i>	55
8.2.5 <i>Përmirësimi permanent i performancës së institucioneve plotësuese – institucioneve që bashkëpunojnë në funksion të zhvillimit rural</i>	56
8.3 Plani i veprimit	58
BURIMET:.....	64
SHTOJCË.....	Error! Bookmark not defined.

1. HYRJE

Ushqimi sot ka dimensione të shumëfishta. Ushqimi është kusht për mbijetesë, një burim pa të cilin nuk mund të jetohej; është mall i tregtueshëm, i krijuar nga bujqësia, pjesë e ekonomisë bujqësore; ushqimi është një burim strategjik elementar që na ofron siguri, na ndihmon në menaxhimin e sistemeve dhe tejkalimin e krizave; ushqimi është një vlerë kombëtare: përmes varieteteve, specialiteteve tradicionale, elementeve të arkitekturës bujqësore, trashëgimisë etnike dhe si përfundim- ushqimi është njohuri në të cilën ndërthuren përvojat e gjeneratave të mëparshme përmes njohurive dhe aftësive tradicionale. Mund të konkludojmë: ushqimi është një nevojë e domosdoshme individuale dhe një përgjegjësi absolute sociale.

Mali i Zi është një vend mesdhetar i vendosur në pjesën juglindore të Detit Adriatik. Sipërfaqja e Malit të Zi është 13,812 km² me rreth 625,000 banorë dhe një dendësi mesatare popullore prej 45 banorë/km². Në Mal të Zi ka 24 komuna dhe 1307 vendbanime. Sipërfaqja e 6 komunave bregdetare zë 11% të sipërfaqes totale të Malit të Zi dhe kjo zonë banohet nga 24% e popullsisë së përgjithshme. Gjatë vitit ka migrime sezonale të popullsisë, kryesisht të lidhura me punësimin në sektorin e turizmit. Sipas të dhënave të censusit të vitit 2011, përqindja më e madhe e popullsisë i përket grupmoshës mbi 65 vjeç, madje 12,8% (burimi i të dhënave MONSTAT).

Sektorin e bujqësisë luan një rol të rëndësishëm në ekonominë e Malit të Zi, me një peshë të konsiderueshme në produktin e brendshëm bruto (8% në 2013, duke përfshirë pylltarinë dhe peshkimin). Pavarësisht se bujqësia, së bashku me sektorin e turizmit, është prioriteti zhvillimor dhe ekonomik i ekonomisë kombëtare, bazuar në statistikat zyrtare (të dhëna nga burime administrative), vetëm 1.6% e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në Mal të Zi janë të punësuar në mënyrë të përhershme në bujqësi¹. Megjithatë, sipas censusit të bujqësisë të vitit 2010, nga gjithsej 620,029 banorë të Malit të Zi, 98,341 janë të punësuar në ferma familjare. Kur kjo shifër shprehet në numrin e njësive vjetore të punës, fitohen 46,473 njësi vjetore të punës, ku një njësi vjetore e punës (në tekstin e mëtejshëm: NJVP) është e barabartë me një punonjës me kohë të plotë. Kjo do të thotë se pothuajse 30% e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në vend janë aktualisht të angazhuar në bujqësi. Epidemia e COVID-19 pati gjithashtu një ndikim të fortë negativ në ekonominë kombëtare në Mal të Zi. Sipas të dhënave të MONSTAT, ekonomia malazeze regjistroi një normë negative të rritjes së vlerës bruto të shtuar prej 15.2% në vitin 2020. Ajo është rezultat i një rënijeje të fortë të tendencave ekonomike gjatë tremujorit të dytë, të tretë dhe të katërt (20.3%, 26.9% dhe 7.5% me bazë vjetore), pas një rritjeje prej 2.6%, të arritur në tremujorin e parë të 2020.

Plani strategjik dhe i veprimit për zbatimin e sistemeve ushqimore të qëndrueshme dhe të arsyeshme në zonën e Ulqinit (2023-2025) mbështetet në tiparet themelore të vendit: mjedisin e ruajtur, biodiversitetin e pasur, burimet natyrore në dispozicion dhe në nivelin aktual të zhvillimit bujqësor, përfshirë orientimin evropian të Malit të Zi. Gjatë përgatitjes së Strategjisë janë respektuar parimet e shumë funksionalitetit të bujqësisë.

¹ MONSTAT, Raport vjetor statistikor nga viti 2014

Bujqësia është një nga aktivitetet kryesore ekonomike në komunën e Ulqinit: sipërfaqet bujqësore përbëjnë gjithsej 7,523 ha dhe pjesa më e madhe e tyre është tokë e punueshme, 5,424 ha (sipas të dhënave kadastrale). Në komunën e Ulqinit bujqësia është dega e dytë më e rëndësishme ekonomike, aktiviteti i parë ekonomik është turizmi. Kombinimi i këtyre dy degëve ekonomike përmes zhvillimit paraqet një nga mundësitë kryesore zhvillimore të komunës së Ulqinit. Shquhet veçanërisht prodhimi i vajit të ullirit, bimëve subtropikale, si ullinjët, agrumet, shegët, bimët mjekësore, produktet e akuakulturës. Po ashtu, është ruajtur ndjeshëm prodhimi i specialiteteve tradicionale gastronomike. Agroturizmi, i cili nuk është zhvilluar në komunën e Ulqinit, paraqet një potencial të veçantë.

Qasja mbi të cilën bazohet zhvillimi i kësaj strategjie përfaqëson vazhdimësinë e strategjive, si kombëtare ashtu edhe lokale, nga periudhat e kaluara programore, të cilat ndoqën nevojat e bujqësisë malazeze. Mali i Zi ka arritur progres të rëndësishëm në periudhën 2014-2020 në harmonizimin e legjislacionit dhe forcimin e institucioneve në përputhje me *Acquis* (legjislacionin) të BE-së, forcimin e ndërgjegjësimit për vlerën dhe cilësinë e ushqimit të prodhuar në fermë dhe filloi zbatimin e programit IPARD përmes një strukture operationale të akredituar përmes të cilës zbatohen pagesa direkte, zbatohet mbrojtja ligjore e produkteve bujqësore tradicionale dhe specifike etj.

Slow Food International është organizatë ndërkombëtare me seli në Itali, e themeluar në vitin 1986 si shenjë proteste ndaj hapjes së *McDonalds* në Romë. Me firmosjen e manifestit në Paris, në vitin 1989, fiton karakter ndërkombëtarë.

Qëllimi i themelimit të kësaj lëvizjeje është që çdokush të ketë qasje ushqimit të mirë, të pastër dhe të shëndoshë. *Slow food* paraqet kënaqësinë që sjell ushqimi, shërben si urëlidhëse e komuniteteve lokale dhe mjedisit, duke mbrojtur kulturën, ushqimin, traditën, biodiversitetin dhe rritjen e vetëdijes se përzgjedhja e ushqimit ka rëndësi për botën që na rrethon.

Qasja bazohet në konceptin e ushqimit që përcakton tre parime të ndërlidhura: I MIRË (ushqim cilësor, i shijshëm dhe i shëndetshëm), I PASTËR (prodhimi që nuk dëmton mjedisin) dhe ushqimi i RREGULLT (çmime të përballueshme për konsumatorët dhe kushte pa hile dhe kompensim për prodhuesit).

Para së gjithash përfitojnë konsumatorët e ushqimit dhe sigurisht prodhuesit. Anëtarët e *Slow Food* kanë përfitime përmes aktiviteteve të ndryshme, sikur në vijim: edukimi, Ark of Taste/Arka e Shijes dhe Presidia, ndërlidhja e komuniteteve, organizimi i eventeve/panaireve të ndryshme. Sot, *Slow Food* është i pranishëm në mbi 160 vende, në mbi 2000 komunitete të krijuara dhe ka miliona mbështetës. Arka e shijes paraqet një listë të produkteve që rrezikojnë të zhduken ose kanë ndonjë specifikë që lidhet me një rajon, proces prodhimi ose përbërje të caktuar. Arka e Shijes është një thesar që mbledh produkte të vogla cilësore që i përkasin kulturës, historisë dhe traditave të të gjithë planetit: një trashëgimi e veçantë frutash, perimesh, kafshëve, djathërave, llojeve të bukës, ëmbëlsirave dhe produkteve të mishit të kuar. Arka e shijes u krijua për të vënë në dukje ekzistencën e këtyre produkteve dhe për të tërhequr vëmendjen për rrezikun e zhdukjes së tyre brenda disa brezave. Biodiversiteti bujqësor dhe sistemet e prodhimit të ushqimit në familje të vogla janë në rrezik në mbarë botën për shkak të industrializimit, erozionit gjenetik, ndryshimeve në modelet e konsumit, ndryshimeve klimatike, braktisjes rurale, migrimin dhe konfliktit. Arka e Shijes fton të gjithë të ndërmarrin

veprime. Në disa raste, produktet duhet të rizbulohen, t'i prezantohen publikut dhe prodhuesit duhet të mbështeten dhe ndihmohen për të treguar historitë e tyre. Në të tjerat, si speciet e egra të rrezikuara, mund të ishte më mirë t'i hani ato më pak ose aspak, gjë që do të favorizonte riprodhimin dhe mbijetesën e tyre.

Kriteret për përfshirje në Arkën e shijes janë si më poshtë:

1. Nominimet për përfshirje në Arkën e shijes mund të përfshijnë: speciet shtëpiake (varietetet bimore, eko-llojet, racat dhe popullatat autoktone të kafshëve), speciet e egra (vetëm nëse janë lidhur me metodat e vjeljes, përpunimin dhe përdorimet tradicionale) dhe produktet e përpunuara; 2. Produktet duhet të jenë të një cilësie të veçantë për nga shija. Cilësia e shijes, në këtë rast, përcaktohet në kontekstin e traditës dhe përdorimit vendas; 3. Produktet duhet të lidhen me një zonë specifike, me kujtesën dhe identitetin e grupit dhe me njohuritë tradicionale lokale; 4. Produktet duhet të prodhohen në sasi të kufizuar; 5. Produktet duhet të jenë në rrezik për shkak të zinxhirëve të brishtë të furnizimit ose konteksteve ekologjike që mund të kërcënohen nga faktorë social, mjedisor ose ekonomik.

Vlerësimet e bazuara në këto kritere duhet të marrin parasysh dallimet në kontekstet lokale dhe duhet të respektojnë situatat e veçanta kulturore, sociale, gjeografike, ekonomike dhe politike të komuniteteve që prodhojnë dhe mbrojnë produktet në fjalë. Aktualisht janë 5,448 produkte nga 150 vende në listën e Arka e shijes.

Përveç Arkës së shijes, është edhe *Presidia Slow Food*. Projekti *Presidia* bashkon një numër të madh prodhuesish të të njëjtit produkt dhe ruan prodhimin cilësor në rrezik zhdukjeje, mbron rajonet dhe ekosistemet unike, rikthen metodat tradicionale të përpunimit, ruan racat vendase dhe varietetet e bimëve vendase.

Aktivitetet kryesore të projektit *Presidia* janë: 1. Kërkimi i prodhuesve, teknikëve dhe institucioneve përkatëse për të përcaktuar objektivat e Presidiumit dhe për të formuar një grup pune; 2. Hetimi i zonës së prodhimit për të mbledhur të dhëna dhe informacione të nevojshme për të krijuar një protokoll prodhimi: një mjet i rëndësishëm për të mundësuar gjurmueshmërinë dhe cilësinë e lartë të produktit; 3. Ndihmon prodhuesit në ndërtimin dhe themelimin e shoqatave të prodhuesve me emrin dhe markën e tyre; 4. Promovon produktet *Presidia* duke u thënë konsumatorëve në mbarë botën se ato janë produkte të jashtëzakonshme dhe se zbulimi, blerja dhe shijimi i tyre do të thotë të mësosh historinë dhe traditat e një territori dhe të ruash trashëgiminë e tij kulturore. *Slow Food International* ka përshkruar udhëzime për kategori të ndryshme projektesh *Presidia*². Aktualisht, në botë ekzistojnë 610 *Presidia*, të cilat mbledhin mbi 13,000 prodhues.

Ky dokument ofron një plan për zbatimin e transformimit strategjik të bujqësisë dhe zonave rurale në komunën e Ulqinit për periudhën 2023-2025, me zbatimin e konceptit *Slow Food*. Si një nga tre sektorët më të rëndësishëm për zhvillimin e vendit, bujqësia e Malit të Zi, qoftë në nivel shtetëror apo në atë vendor, kërkon vëmendjen e plotë të politikëbërësve dhe institucioneve përkatëse vendore dhe shtetërore, e cila do të sigurohet nga zbatimi, të një sërë aktiviteteve dhe masash të ndryshme të financuara nga buxheti vendor dhe kombëtar, si dhe nga fondet e Bankës Botërore dhe BE-së.

² <https://www.fondazione Slow Food.com/en/what-we-do/slow-food-presidia/>

1.2 Qëllimi i përgjithshëm

Qëllimi i përgjithshëm i *Planit strategjik dhe të veprimit për zbatimin e sistemeve të qëndrueshme dhe të arsyeshme ushqimore në zonën e Ulqinit (2023-2025)* është rritja e prodhimit bujqësor në nivel lokal, rritja e shitjeve të drejtpërdrejta në tregjet lokale dhe rajonale, duke përfshirë produktet tradicionale, ndikojnë në zhvillimin e formave të thjeshtuara të përpunimit në njësitë e vogla bujqësore, duke iu përmbajtur parimit të përgjegjësisë, duke i ofruar popullatës vendase produkte bujqësore të freskëta dhe cilësore dhe, në fund të fundit, duke promovuar dhe ruajtur reputacionin e fituar të specifikave vendase.

Sot, tashmë thellë në shekullin e 21-të, ne jemi plotësisht të vetëdijshëm se modeli i mëparshëm bujqësor është konsumuar, se industrializimi i bujqësisë ka çuar në shkatërrimin rajonal të kësaj dege të ekonomisë, së bashku me destabilizimin e të gjitha sistemeve të mëparshme të vlerave që bazoheshin pikërisht në vlerën e prodhimit të ushqimit. Jemi të vetëdijshëm se diversifikimi i aktiviteteve bujqësore është aktualisht pjesa më e kërcënuar e diversifikimit në botë, me zhdukjen e përsheptuar të varieteteve të shumta të kulturave bimore dhe racave të kafshëve shtëpiake, por edhe aftësitë e mëparshme bujqësore dhe njohuritë për prodhimin dhe ruajtjen e produktet, mbijetesa themelore e njeriut dhe e qytetërimit. Nevojitet planifikim afatgjatë i prodhimit dhe vetëfurnizimit me ushqime, së bashku me krijimin e një teprice produktesh të justifikuara organikisht dhe ekonomikisht.

Katër qëllime strategjike janë përcaktuar qartë më poshtë, përkatësisht:

1. Prodhues bujqësor konkurrues;
2. Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe standardi i lartë social;
3. Zhvillimi i ekuilibruar dhe i qëndrueshëm;
4. Njohshmëria e identitetit ulqinak.

Brenda objektivit strategjik 1, një prodhues bujqësor konkurrues duhet të ofrojë mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe të krijojë parakushte për investime në ekonomi dhe zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme mbi baza tradicionale dhe zhvillimin e bujqësisë dhe peshkimit me masat e mëposhtme:

- (1) Përmirësimi i infrastrukturës për zhvillimin e bujqësisë dhe peshkimit;
- (2) Zhvillimi i zonave rurale; zhvillimi i sipërmarrjes rurale; zhvillimi i agroturizmit;
- (3) Vlerësimi dhe përmirësimi i prodhimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore autoktone;
- (4) Zhvillimi i peshkimit.

Në kuadër të objektivit strategjik 4 - njohja e identitetit të Ulqinit janë përcaktuar këto prioritete:

- (1) Ruajtja e diversitetit biologjik natyror në funksion të zhvillimit (masat: valorizimi dhe mbrojtja e vlerave natyrore dhe forcimi i institucioneve në fushën e mbrojtjes së mjedisit);

(2) Ruajtja e trashëgimisë kulturore në funksion të zhvillimit (masa: themelimi dhe rrijtëzimi i institucioneve të rëndësishme për zhvillimin kulturor dhe identitetin e njohur ulqinak; ruajtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale dhe edukimi për të ushqyer identitetin ulqinak dhe njohshmërinë e tij);

(3) Zhvillimi i multikulturalizmit (masa: përmirësimi i punës së institucioneve dhe këshillave të pakicave kombëtare).

1.2 Kuadri ligjor

Korniza ligjore e Strategjisë përcaktohet me Ligjin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.³ Ligji për Bujqësi dhe Zhvillim Rural është dokumenti ligjor bazë i politikës agrare. Ky ligj, ndër të tjera, rregullon: planifikimin e zhvillimit të bujqësisë dhe zonave rurale, masat e politikës bujqësore, stimulimet për bujqësinë dhe zhvillimin rural, kushtet për zbatimin e tyre, përfituesit e stimulimeve, organizimin e prodhuesve, cilësinë dhe etiketimin e produkteve bujqësore, tregtia e produkteve bujqësore, aktivitetet plotësuese, punët me interes publik, regjistrat dhe regjistrimet, si dhe çështje të tjera me rëndësi për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale. Rëndësia e politikës agrare përshkruhet në detaje në kapitullin mbi masat e politikave, ndërsa politika e përgjithshme agrare është paraqitur në katër grupe kryesore: politika e çmimeve të tregut, politika e zhvillimit rural, çështjet e interesit publik dhe transfertat sociale në fermat familjare.

Ligji mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (2014) përcaktoi se dokumentet strategjike për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale duhet të përcaktojnë drejtimet afatgjata të zhvillimit të politikave bujqësore. Përveç ligjit ombrellë të përmendur, bazë për dokumentin strategjik sigurisht që janë ligjet dhe rregulloret e tjera në Mal të Zi, të cilat në masë të madhe janë të harmonizuara me rregulloret e BE-së.

2. BAZA NATYRORE DHE SHOQËRORE PËR ZHVILLIM TË BUJQËSISË NË ULQIN

Për këtë kapitull janë shfrytëzuar në pjesën më të madhe të dhënat e Planit Zhvillimor Strategjik të Komunës së Ulqinit për periudhën 2016-2020.

2.1 Pozita gjeografike

Komuna e Ulqinit ndodhet në bregun lindor të detit Adriatik dhe është komuna më jugore në Mal të Zi. Ajo mbulon një sipërfaqe prej 255 km² dhe është një nga komunat më të vogla në vend për nga madhësia.

³ Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", numër 56/2009 dhe ndryshimet 18/2011 - ligji tjetër, 40/2011 - ligji tjetër, 34/2014, 1/2015, 30/2017 dhe 51/2017 - ligji tjetër dhe 59/2021....) në nenin 4 parashikon një dispozitë për zhvillimin e Strategjisë për Prodhimin Ushqimor dhe Zhvillimin e Zonave Rurale, e cila përcakton drejtimet afatgjata të zhvillimit të bujqësisë.

Në pjesën jugore, në një gjatësi prej 32 kilometrash, Ulqini del në detin Adriatik, në pjesën lindore gjendet lumi Buna, gjegjësisht Republika e Shqipërisë, pika më perëndimore është ishulli Ulqini i Vjetër dhe në veri është i rrethuar nga masivi i malit Rumisë.

Komuna e Ulqinit ka një peizazh dhe biodiversitet specifik dhe unik në Mal të Zi, i përbërë nga Plazhi i Madh me duna ranore dhe bimë halofitike, kënetat, Buna, kriporja, liqeni i Shasit, Valdanosi dhe ullishtat e tij shekullore.



Foto 1. Pozita gjeografike e komunës së Ulqinit

2.2 Klima

Ulqini ka një klimë mesdhetare, me verë shumë të nxehtë dhe të thatë, me periudha të moderuara të vjeshtës dhe pranverës, me sasi relativisht të vogla të reshjeve dhe dimër të butë. Temperaturat mesatare mujore variojnë nga 6,9°C në janar në 24,3°C në korrik dhe gusht, me një temperaturë mesatare vjetore prej 15,8°C.

Niveli vjetor i diellit në zonën e Ulqinit është rreth 270 orë (7,4 orë në ditë) dhe është në vendin e parë në Mal të Zi. Kjo është arsyeja që shpesh quhet qyteti i diellit. Kjo është komuna me sasinë më të vogël të reshjeve (reshjet mesatare vjetore në Ulqin janë 1,247 l/m²). Erërat në zonën e Ulqinit fryjnë pothuajse çdo ditë dhe vetëm 3.9% ose 14.23 ditë të vitit janë të qeta. Prandaj, zona e Ulqinit është e përshtatshme për ndërtimin e centraleve me erë. Erërat më karakteristike janë maestrali, era lindore, era jugore dhe murrhani.

2.3 Lumenjtë

Lumi Buna është një lumë pjesërisht i lundrueshëm, ndërkombëtar. Është 43 km i gjatë dhe ka dy furnizues kryesor: Moraçen në Mal të Zi dhe degën e Drinit në Shqipëri. Ai rrjedh nga Liqeni i Shkodrës për 18 km nëpër territorin shqiptar, ndërsa 25 km e mbetur përfaqësojnë kufirin midis Malit të Zi dhe Shqipërisë. Thellësia mesatare e Bunës është prej 3 deri në 5 m, në disa pjesë i kalon 8 m. Në grykëderdhjen e lumit dallgët e detit kanë krijuar një shkëmbë, i cili shihet kur niveli i ujit është i ulët dhe quhet Ada e Vogël.

Lumi i Rashtishës është rrjedhë që derdhet në Bunë në territorin e Malit të Zi. Ai buron nga disa përrenj më të vegjël të ndërprerë, të cilët formohen nga burimet në shpatet juglindore të Rumisë. Pranë vendit Lisën Bore derdhet në Bunë. Gjatësia e përroit është rreth 7 km, dhe sipërfaqja e pellgut është rreth 25 km².

Lumi i Milles (Katerkollës) buron nga një sërë burimesh në shpatet juglindore të Rumisë, me kontakt të akuiferit karstik dhe sedimenteve të papërshkueshme flishore. Nga vendi i Katërkollës rrjedh i përqendruar në drejtim të juglindjes në vendin e Lisën Bore, ku derdhet në lumin Buna. Gjatësia e përroit është rreth 15.5 km, dhe sipërfaqja e pellgut është rreth 31 km².

Lumi i Megjureshit buron nga një sërë burimesh në zonën e Megjureshit (shpatet jugore të Rumisë). Nga Megjureshi deri në Kaliman, në një gjatësi prej rreth 2 km, rrjedh në drejtim të jugut, deri në grykëderdhjen e liqenit të Shasit. Ujërat e liqenit të Shasit derdhen në lumin Buna. Gjatësia e përroit është rreth 19.5 km, dhe sipërfaqja e pellgut është rreth 55 km².

2.4 Liqenet

Liqeni i Shasit ndodhet në veri të komunës së Ulqinit, në zonën e Anës së Malit. Ndodhet midis lartësive gëlqerore të Kodrës së Shasit dhe Malit të Brisë. Lumi i Megjureshit derdhet në liqen nga veriperëndimi, kurse kanali i Shën Gjergjit ndodhet në skajin juglindor të terrenit. Sipërfaqja dhe vëllimi i liqenit ndryshon gjatë vitit në varësi të kushteve hidrologjike. Thellësia më e madhe e liqenit është rreth 8 m, mesatarja është rreth 5-6 m. Në ujëra mesatare, sipërfaqja e liqenit është rreth 3 km².

Liqeni i Zogajve paraqet një relik të kushteve historike hidrologjike. Ka shumë teori për origjinën e këtij aluvioni, por është e sigurt se gjatë përmytjeve të mëdha në pellgun e Bunës dhe Drinit, në nëntor të vitit 1886, ai mori formën e një objekti natyror hidrografik me derdhjen e tij në detin Adriatik – kanalin e Port Milenes. Më vonë, ndërhyrjet njerëzore në këtë zonë, veçanërisht ndërtimi i kriporës dhe argjinaturave të kriporës, i dhanë formën aktuale të saj.

2.5 Deti

Në strukturën fizike të shtratit të detit, dallohen tre lloje kryesore dhe të zhvilluara mirë - fundi shkëmbor, ranor dhe me baltë. Uji i detit ka një përbërje kimike të larmishme dhe përmban natrium, magnez, kalcium, kalium, stroncium dhe elementë të tjerë në sasi më të vogla. Kripësia e ujit të detit ndryshon. Në zonën nën ndikimin e Bunës vlerat e regjistruara janë 29.70% e më të ulëta. Në të njëjtën kohë, këto vlera në det të hapur rriten deri në 39 %, në kohën e prurjeve më të forta të ujërave mesdhetare. Temperatura mesatare vjetore e detit është 17.1°C. Temperatura e shtresave të thella ujore sillet rreth 11°C dhe ujërave sipërfaqësore deri në 25°C gjatë periudhës së verës. Temperatura e ujit është mbi 18°C për më shumë se gjashtë muaj, dhe mbi 20°C për më shumë se katër muaj (nga 6 maji deri më 4 nëntor, pra 182 ditë). Sezoni i notit fillon kur temperatura e ujit të detit është më e lartë se 20°C, që është mesatarisht nga 28 maji deri më 14 tetor, pra 140 ditë në vit.

2.6 Toka

Mbulesa pedologjike e zonës së Ulqinit karakterizohet nga një prani e konsiderueshme e tokave potencialisht pjellore në raport me zonat e tjera të Malit të Zi dhe veçanërisht në raport me rajonin bregdetar malazez. Kapacitetet tokësore në rrafshnalta janë veçanërisht të rëndësishme, sepse Ulqini, territori i të cilit përbën 1.8% të territorit të Malit të Zi, ka rreth 8500 ha toka të thella lumore në rrafshnalta (pa kripore dhe sipërfaqe ujore), që është rreth 14% e të gjitha rrafshnaltave në Mal të Zi dhe mbi 60% e rrafshnaltave në rajonin bregdetar.

2.7 Të dhënat demografike

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, në territorin e komunës së Ulqinit jetojnë 19,921 banorë (3,21% e popullsisë së përgjithshme të Malit të Zi) dhe 5,440 amvisëri. Nga numri i përgjithshëm i banorëve, 49,9% janë meshkuj (9,938), dhe 50,1% janë femra (9,983).

Nga ky numër, 10,707 banorë (53,74%) jetojnë në zonën urbane, ndërsa 9,214 (46,26%) jetojnë në zonën rurale. Numri i popullsisë urbane është më i ulët se mesatarja e Malit të Zi (64.4% e popullsisë urbane dhe 35.6% e popullsisë rurale).

Sipas regjistrimit të fundit, dendësia e popullsisë në Ulqin është 78,1 banorë/km². Megjithatë, ende është mbi mesataren në Mal të Zi (44.9 st/km²).



Foto 2. Dendësia e popullsisë sipas komunave në vitin 2011 (Burimi MONSTAT)

Regjistrimi (2011) konfirmoi vazhdimin e trendit të plakjes dhe rritjen më të ngadaltë të numrit të popullsisë së Malit të Zi. Në kombinim me migrimin e brendshëm dhe të jashtëm, kjo ndikon

ndjeshëm në ndryshimin e pasqyrës demografike të Malit të Zi. Tendencat e rritjes së popullsisë për periudhën 1981–2011 janë paraqitur në tabelën 1.

Tabela 1: Tendencat e rritjes së numrit të popullsisë në Mal të Zi 1981–2011

Rajoni	Popullsia	Sipërfaqja (km ²)	Dendësia e popullsisë	Banorët %	Territori %
Verior	177.837	7.304	24,35	28,7	52,9
Qendrorë	293.509	4.917	59,69	47,3	35,6
Bregdetar	148.683	1.591	93,45	24,0	11,5

Burimi: MONSTAT, Raporti vjetor statistikor për vitin 2013.

Sipas të dhënave të MONSTAT, numri i popullsisë së Malit të Zi është rritur në periudhën nga viti 1981 e deri më sot, por kjo rritje është shumë e pabarabartë nëpër rajone. Çdo regjistrim tregon një rritje të numrit të banorëve në rajonin qendror dhe bregdetar, ndërsa ka një rënie në rajonin verior.

Ekzistojnë dy tendenca të dukshme në migrimin e popullsisë ndërmjet dy regjistrimeve (2003 dhe 2011): i pari është migrimi i konsiderueshëm nga rajoni verior dhe **i dyti është migrimi nga zonat rurale në ato urbane.**

Të lartpërmendurat kontribuuan në zhvillimin e pabarabartë të rajoneve qendrore, veriore dhe bregdetare të Malit të Zi. Rajoni verior përfaqëson më shumë se 50% të territorit të vendit, por është i banuar nga më pak se një e treta e popullsisë së përgjithshme. Nga ana tjetër, pothuajse një e katërta e popullsisë në Mal të Zi banon pak më shumë se 10% të territorit, i cili ndodhet në rajonin bregdetarë

2.8 Struktura moshore e popullsisë

Ashtu si në pjesët tjera të Malit të Zi, struktura moshore në Ulqin është shumë e pafavorshme. Që nga viti 1981, kur ritmi i rritjes së popullsisë ishte 11.8%, ka qenë në rënie të vazhdueshme, kështu që në vitin 2012 ishte 2.5%. Moshë mesatare në Mal të Zi, sipas regjistrimit të vitit 2011, është 34 vjeç. Vendbanimet rurale në të gjitha komunat kanë një strukturë moshore shumë më të pafavorshme se ato urbane, d.m.th. në disa vendbanime rurale moshë mesatare e popullsisë është mbi 50 vjeç. Të dhënat nga regjistrimi i vitit 2011, tregojnë se struktura moshore e komunës së Ulqinit është shumë e ngjashme me atë të përfaqësuar në nivelin e Malit të Zi, ku ata që janë mbi 65 vjeç përbëjnë 14% të popullsisë, dhe 19% e përbëjnë ata nën 15 vjeç. Struktura moshore e Ulqinit, njëkohësisht e Malit të Zi, kërkon një qasje shumë serioze për zgjidhjen e saj, sepse njeriu me fuqi të plotë punëtore është shtylla bazë e zhvillimit të ekonomisë, pra dhe të bujqësisë.

2.9 Punësimi

Nga numri i përgjithshëm i banorëve në komunën e Ulqinit, 6.24 prej tyre (ose 31%) përfaqësojnë pjesën aktive. Popullsia bujqësore, me 7.8%, përbën një pjesë të konsiderueshme të popullsisë aktive (në nivelin e Malit të Zi, kjo përqindje është 2.5). Në komunën e Ulqinit janë të punësuar gjithsej 4,848 banorë (pra 24,33% e numrit të përgjithshëm të banorëve ose

mbi 78% e popullsisë aktive); gratë marrin pjesë me një të tretën e numrit të përgjithshëm të të punësuarve. Numri më i madh i të punësuarve është në turizëm (kryesisht hotele dhe restorante - 17.5%) dhe në tregtinë me shumicë dhe pakicë (14%)⁴. Megjithatë, turizmi në zonat rurale të Ulqinit nuk është i zhvilluar.

Rëndësia e turizmit rural duhet të merret parasysh, sepse është ndërveprimi i prodhimit bujqësor, prezantimit të traditës, gastronomisë tradicionale dhe shërbimeve turistike. Me një fjalë, përdorimi i burimeve tashmë ekzistuese. Prandaj, zhvillimi i turizmit rural bazohet në zhvillimin e qëndrueshëm, përmes rivitalizimit të objekteve tashmë ekzistuese tradicionale, gjegjësisht të trashëgimisë, të cilës i jepet një qëllim i ri – ai turistik. Duke planifikuar një rinovim, valorizim dhe mbrojtjen më të plotë të potencialeve turistike, krijohet një produkt integral turistik, i cili lidhet me zbatimin e programit të rivitalizimit të zonës rurale, me programin e zhvillimit, por edhe me programin e markimit të destinacionit turistik rural. Prandaj, turizmi rural, veçanërisht turizmi në fermat bujqësore, është një pjesë e rëndësishme e zhvillimit të përgjithshëm dhe të qëndrueshëm.

Tabela 2: Ndarja e netëqëndrimeve sipas destinacioneve të ndryshme turistike (Burimi: MONSTAT, 2015)

Llojet e vendeve turistike	Fjetjet	Pjesëmarrja e vendit në numrin total (në %)	Shkalla e ndryshimit 14/13 (në %)
Vendet bregdetare*	9.258	96,9	1,4
Vendet malore**	90	1,0	-16
Vendet e tjera turistike ***	75	0,8	33,9
Kryeqyteti	128	1,3	9,9
Vendet e tjera****	2	0,0	-26,1
Gjithsej	9.453	100,0	1,5

*Ulqin, Tivar, Budva, Tivat, Kotorr dhe Herceg Novi

** Zhablak, Kolashin, Plavë, Pluzhinë, Rozhajë dhe Andrijevicë

*** Bijelo Pole, Berane, Mojkovac, Nikshiq, Shavnik, Plevlë dhe Cetinjë

**** Danilovgrad

2.10 Trashëgimia kulturore dhe natyrore

Në këtë kapitull janë shfrytëzuar të dhënat nga Plani Zhvillimor Strategjik i Komunës së Ulqinit për periudhën 2016-2020. Të dhënat janë të rëndësishme për modelet më të mira të zhvillimit të infrastrukturës bujqësore dhe rurale. Sigurimi i kushteve adekuate të punës dhe të jetesës në

⁴ Burimi: Enti Statistikor i Malit të Zi, Regjistrimi i Popullsisë 2011. Të dhënat në nivel komunal, Zyra e Punësimit Mali i Zi

zonat rurale me përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore, ruajtjen dhe mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit është një detyrë e përhershme. Mbrojtja duhet të zbatohet në të gjitha aktivitetet, veçanërisht ato ekonomike, të cilat ndikojnë në ndryshimet në hapësirë dhe mjedis. Gjithashtu, ruajtja e trashëgimisë kulturore-historike të ndërtuar në zonën e Ulqinit është një detyrë e rëndësishme për banorët e sotëm, të cilët duhet ta mbrojnë dhe ruajnë këtë trashëgimi për brezat e ardhshëm.

Ulqini është një nga qytetet më të vjetra në bregdetin e Adriatikut, duke i rezistuar provës së kohës për 25 shekuj. Gjurmët më të hershme i gjejmë në kohët parahistorike, kur Ulqini i përkiste ilirëve. Colchinium i lashtë ose Olcinium, siç quhej ky qytet gjatë perandorive greke dhe romake, përmendet në burimet e shkruara nga Plini Plaku, në veprën "*Naturalis historiae*", ndërsa në veprat e tij Ulqinin përmend edhe Titus Livius.

Në periudhën më të hershme emri i perandorit bizantin Justinian lidhet me zhvillimin kulturor dhe historik të Ulqinit. Ai restauroi dhe ndërtoi fortifikime në Ulqin dhe pas periudhës së mbretërimit të tij pas vitit 1100, të njëjtën gjë bënë edhe sundimtarët e famshëm që qeverisnin një pjesë të Malit të Zi dhe bregdetit të sotëm: Nemanjiqët, Balshiqët, Venedikasit dhe Osmanët. Në kohën e Nemanjiqëve dhe Balshiqëve. Ulqini ishte i njohur edhe për monedhat e tij prej bronzi dhe argjendi.

Pas betejës detare në Lepanto (1571), shkrimtari i njohur spanjoll *Miguel de Cervantes Savedra* qëndroi i burgosur në Ulqin. Besohet se, së bashku me skllëvër të tjerë, ai u shit në një vend që tani quhet Sheshi i Skllëvërve ose Sheshi Servantes, dhe ndodhet në Kala.

Gjatë periudhës së Perandorisë Osmane, Ulqini përjetoi një ngritje të ndjeshme, duke u bërë një qendër e rëndësishme detare dhe tregtare.

Në të kaluarën, Kalaja e Ulqinit ishte gjithashtu një strehë për reformatorin e famshëm hebre Sabatai Cevi (1626–1676), i cili vdiq atje.

Kur flasim për traditën dhe kulturën në përgatitjen e ushqimeve, kuzhina ulqinake zë një vend të lartë në Mal të Zi. Gatimet tradicionale janë ruajtur prej shekujsh dhe janë krijuar kryesisht nën ndikimin e fortë të kulturave përreth, me dominim orientalo-mesdhetar. Ajo që është shumë interesante, recetat autentike, mënyrat e përgatitjes së ushqimit dhe zakonet që lidhen me të janë të pandryshuara edhe sot e kësaj dite, megjithëse ndikimi i standardizimit në nivel global është shumë i fortë.

Krahina e komunës së Ulqinit karakterizohet me bukuri natyrore, të cilat klasifikohen si monumente natyrore të Malit të Zi. Këto janë Plazhi i Madh, Plazhi i Vogël dhe plazhi Valdanos. Ishulli i Ulqinit të Vjetër klasifikohet si zonë me veçori të veçanta natyrore.

Llojet e rralla dhe endemike bimore dhe shtazore janë të pranishme edhe në territorin e komunës së Ulqinit. Janë identifikuar më shumë se 250 lloje zogjsh. Siç është shkruar në kapitujt e mëparshëm, kriporja e Ulqinit me habitatet e lagështa është një zonë e rëndësishme për qëndrimin dhe dimërimin e zogjve (ujorë).

Më e gjata nga të gjitha këto është Plazhi i Madh, i cila ndodhet në lindje të qytetit të Ulqinit dhe Portit të Milenës, dhe është një plazh me rërë me një gjatësi totale prej 10.1 km. Ky plazh, i cili për bukurinë e tij me meritë ka marrë emrin Kopakabana e Malit të Zi, shtrihet nga Porti i Milenës deri në grykëderdhjen e lumit Buna. Plazhi i Madh është rreth 4 km nga qyteti i Ulqinit. Dunat e rërës në Plazhin e Madh janë ndër strehët e fundit të bimësisë unike dhe të rrallë halofitike. Megjithatë, për shkak të zhvillimit jo mjaftueshëm të kontrolluar turistik dhe urban, si dhe për shkak të rritjes së shkarkimit të ujërave të zeza të ndotura dhe të patrajuara në det, ky ekosistem është i kërcënuar.

Plazhi i Vogël shtrihet nga Punta e Nuredinit, ku ngrihet Qyteti i Vjetër, deri në Kepin e Sukës. Është në formë gjysmërrethore, rreth 430 m i gjatë.

Valdanosi ndodhet 4 km në veriperëndim të Ulqinit. Ullishta e vjetër në Valdanos, me 18 000 pemë, është pjesë e një kompleksi më të madh, i cili shtrihet deri në vetë qytetin e Ulqinit. Moshja e këtyre pemëve është deri në 2 000 vjet dhe ka të tilla që kanë ekzistuar që nga periudha e Greqisë antike.

Gjithashtu, ishulli i Ulqinit të Vjetër është një rajon me veçori të veçanta natyrore. Ndodhet në një ishull të vogël, afër bregut midis Tivarit dhe Ulqinit. Sot, në ishull ka mbetje më të vogla të mureve, të vendosura në pjesën perëndimore dhe pjesërisht në pjesën veriore. Brigjet lindore dhe jugore janë të pjerrëta dhe shkëmbore, ndaj nuk kishte nevojë të ndërtoheshin mure mbrojtëse. Në ishull ka edhe mbetje ndërtesash të brendshme - shtëpi më të vogla, si dhe një kishë me një nefshe me një varr nëntokësor të rrethuar në skajin perëndimor. Në të gjithë sipërfaqen e ishullit gjenden copa enësh qeramike, të cilat i përkasin kohëve të lashta.

Në kuadër të Planit Hapësinor të Malit të Zi, parashihet të vendoset nën mbrojtje Kriporja e Ulqinit me kënetë, Ada e Bunës dhe ishulli Ulqini Vjetër si vend unik botanik dhe zoologjik. Gjithashtu është planifikuar rregullimi i shtratit të lumit Buna dhe ndërtimi i argjaturës, për të parandaluar përmytjet dhe njëkohësisht degradimin e zonës.

2.11 Turizmi në zonat rurale

Turizmi është dega më e rëndësishme ekonomike e komunës së Ulqinit. Rreth 32 kilometra nga bregdeti i Adriatikut përfaqësojnë burimin më të rëndësishëm ekonomik të kësaj komune.

Si pjesë e ekonomisë së turizmit, turizmi rural nënkupton valorizimin turistik të zonave bujqësore, burimeve natyrore, trashëgimisë kulturore, monumenteve fetare, zakoneve tradicionale lokale, si një formë e veçantë e prodhimit dhe markës turistike, të cilat së bashku formojnë identitetin e zonës dhe kënaqin nevojat e mysafirëve për akomodim, shërbime, ushqim, pije, rekreacion, aktivitete sportive dhe ngjarje.

Mbështetja për zhvillimin e turizmit - komplementariteti i bujqësisë me turizmin ka një rëndësi gjithnjë e më të madhe pasi një përzgjedhje e gjerë e produkteve vendase pasuron ofertën turistike dhe e bën atë unike, kështu që turizmi përmes afirmimit të kuzhinës kombëtare dhe produkteve specifike malazeze është një gjenerues i fuqishëm i zhvillimit të bujqësisë.

Duhet të merret parasysh edhe rëndësia e turizmit rural, sepse është ndërveprimi i prodhimit bujqësor, prezantimit të traditës, gastronomisë tradicionale dhe shërbimeve turistike. Me një fjalë, kemi të bëjmë me përdorimin e burimeve tashmë ekzistuese. Prandaj, zhvillimi i turizmit rural bazohet në zhvillimin e qëndrueshëm, përmes rivitalizimit të objekteve tashmë ekzistuese tradicionale, gjegjësisht të trashëgimisë, të cilës i jepet një qëllim i ri – ai turistik. Duke planifikuar rinovimin, valorizimin dhe mbrojtjen më të plotë të potencialeve turistike, krijohet një produkt integral turistik, i cili lidhet me zbatimin e programit të rivitalizimit të zonës rurale, me programin e zhvillimit, por edhe me programin e markimit të destinacionit turistik rural.

Fusha e turizmit në Mal të Zi është nën juridiksionin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Turizmi përfaqëson aktivitetin më të rëndësishëm ekonomik në Mal të Zi. Numri i mysafirëve tregon rritje të vazhdueshme, kështu që në vitin 2018 ka pasur 2,2 milionë mysafirë me 12,9 milionë bujtje, kurse në vitin 2019 - 2,64 milionë mysafirë me 14,45 milionë bujtje, nga të cilët 95% janë turistë nga jashtë. Sa i përket llojit të destinacioneve të vizituara nga numri më i madh i turistëve, deri në 85% vijnë në qytetet bregdetare, ndërsa qendrat malore vizitohen nga 4.3%, dhe kryeqyteti nga 7% e mysafirëve. Gjithashtu, numri më i madh i turistëve e vizitojnë Malin e Zi gjatë muajve të verës, nga maji deri në tetor. Problemi më i madh është potenciali i pamjaftueshëm i akomodimit. Si rezultat, sezoni është i kufizuar në vetëm tre muaj (nga qershori në gusht).

2.12 Zonat rurale

Termi "rurale" nuk u përkufizua saktësisht për një kohë të gjatë dhe kufizohej kryesisht në një term të fjalëpërfjalshëm, që nënkuptonte zona me një mjedis natyror rural, duke përfshirë fshatrat, vendbanimet më të vogla, etj., me bujqësinë dhe pylltarinë si karakteristika kryesore ekonomike.

Sipas metodologjisë së OECD, i gjithë territori i Malit të Zi mund të konsiderohet rural. Megjithatë, duke marrë parasysh pabarazitë e theksuara ndërmjet njësive territoriale në nivel lokal (komunat) dhe duke marrë parasysh specifikat e tjera që lidhen me Malin e Zi, propozohet qasja e mëposhtme për përcaktimin e zonave rurale: nëse komuna ka më shumë se 10,000 banorë në qendrat urbane, dmth. në vendbanimet që MONSTAT i klasifikon si urbane dhe që administrativisht i përkasin qendrave urbane, këto vendbanime nuk klasifikohen si zona rurale, ndërsa pjesa e mbetur e territorit të asaj komune është. Nga ana tjetër, komunat që kishin më pak se 10,000 banorë që jetonin në vendbanime urbane në regjistrimin e vitit 2011 u klasifikuan si zona rurale. Ndarja e propozuar është pasqyrimi më i mirë i situatës aktuale në Mal të Zi.

Tabela 3: Paraqitja e numrit të popullsisë urbane dhe rurale sipas rajoneve

Rajoni	Numri i banorëve	Popullata urbane		Popullata rurale	
		Numri	%	Numri	%
Bregdetar	148.683	86.707	58,3	61.976	41,7

Qendrorë	293.509	233.640	79,6	59.869	20,4
Verior	177.837	71.673	40,3	106.164	59,7
Mali Zi gjithsej	620.029	392.020	63,2	228.009	36,8

Burimi: MONSTAT, Regjistrimi i popullsisë për vitin 2011.

Duke analizuar të dhënat në dispozicion, të renditura në tabelën e mëparshme, mund të konkludojmë se si për rajonin bregdetar ashtu edhe për komunën e Ulqinit, pothuajse gjysma e popullsisë jeton në zonat rurale.

3. ZHVILLIMI DHE GJENDJA E BUJQËSISË NË ULQIN

Ullinj të dhe vaji i ullirit, frutat, perimet, peshku, specialitetet tradicionale gastronomike janë themeli i bujqësisë së Ulqinit. Ullishtat e vjetra, livadhet, kullotat, fushat e punueshme, kopshtet janë kyçe për krijimin e zonave të Ulqinit dhe ruajtjen e të gjithë diversitetit biologjik. Me evolucionin e bujqësisë, disa produkte dhe ushqime bujqësore zhvillohen në numër të madh dhe disa shuhen. Disa janë rritur tradicionalisht këtu për mijëra vjet, disa për vetëm njëqind vjet, dhe disa mund të jenë zhdukur përgjithmonë. Kështu ullishtat mbijetuan për disa mijëra vjet, specialitete tradicionale madje më gjatë. Ullishtaria dhe specialitetet tradicionale po zhvillohen dhe përmirësohen vazhdimisht, prandaj sot, në shekullin XXI, Ulqini mund të krenohet me këto xhevahire të bujqësisë së tij.

Bujqësia ka qenë gjithmonë një degë e rëndësishme ekonomike në Ulqin. Deri në mesin e shekullit të 20-të ishte veprimtaria kryesore, kurse deri në fund të atij shekulli roli i saj në Ulqin pësoi rënie konstante. Edhe pse kishte kushte të favorshme natyrore për zhvillim evolucionar, bujqësia u zhvillua shumë ngadalë për shkak të proceseve intensive të deagrarizimit dhe shpopullimit të fshatrave, të cilat u mbështetën nga politikëbërësit e kohës shumë më tepër nga viti 1945 deri në vitet nëntëdhjetë. Sipërfaqja e tokës bujqësore në Ulqin është në rënie të vazhdueshme për shkak të mosshfrytëzimit, urbanizimit, ndërtimit të infrastrukturës dhe objekteve të banimit. Prodhuesit kryesorë bujqësorë janë fermat e vogla: kultivimi i ullirit, përpunimi i ullirit, perimtaria, rritja e perimeve, rritja e luleve dhe specialitetet tradicionale.

Zhvillimi i bujqësisë së Ulqinit është i kufizuar nga pamundësia e prodhimit intensiv për shkak të mbrojtjes së ujërave nëntokësore dhe mbitokësore dhe detit, infrastrukturës së pazhvilluar të ujëtuajtjes, industrisë ushqimore të pazhvilluar, sektorit të paorganizuar të prodhimit, rrezikut të dëmtimeve nga fatkeqësitë natyrore (thatësira, temperaturat e ulëta të dimrit), moszhvillimi i infrastrukturës së tregut. Duke qenë se toka dhe hapësira natyrore përdoren në veprimtari bujqësore, mbrojtja dhe zhvillimi i tyre është i rëndësishëm dhe rëndësia e bujqësisë i kalon kufijtë e matshëm me tregues ekonomikë dhe të prodhimit.

3.1 Të dhënat e disponueshme dhe infrastruktura e qeverisjes lokale

Vetëqeverisja lokale në komunën e Ulqinit organizohet duke u ndarë në disa sekretariate dhe shërbime. Kryen detyra që lidhen me monitorimin dhe përmirësimin e sistemit të vetëqeverisjes

lokale dhe formave të menjëhershme të vetëqeverisjes lokale, hartimin e rregulloreve që lidhen me sistemin e vetëqeverisjes lokale, organizimin e qeverisjes lokale dhe rregullore të tjera. Sekretariati për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Ekologji, i cili aktualisht ka dy zyrtarë dhe një udhëheqës/e, është përgjegjës për zhvillimin e bujqësisë, monitorimin dhe propozimin e programeve dhe masave mbështetëse.

Në vitin 2022, administrata lokale e Ulqinit ka buxhetuar 80,000.00 euro për prodhimtari bujqësore në buxhetin lokal. Deri në fillim të tetorit vitit 2022, vetëqeverisja lokale nuk i ka paguar asnjë prodhuesi bujqësor mbështetjen e planifikuar dhe në gusht të vitit 2022 ka bërë ribalancimin, i cili e ka ulur mbështetjen për bujqësinë në 20,000.00 euro.

Të dhënat që disponon vetëqeverisja lokale për prodhimin bujqësor, strukturën e tokës, sektorët dominues, potencialet, etj. janë shumë të kufizuara, të rralla, individuale dhe inekzistente. Në dispozicion janë të dhënat vijuese:

1.900 amvisëri janë të angazhuara në veprimtari bujqësore, parësore dhe dytësore; Sektorët prodhues më të përfaqësuar janë:

- Kultivimi i perimeve të hershme (prodhimi në serrë), rreth 50 ha, kultivimi i perimeve në hapësirë të hapur, rreth 1000 ha;
- Blegtoaria, me rreth 3.000 lopë qumështore, 7.000 dele dhe dhi, 30.000 shpendë, rreth 3.000 koshere bletësh etj.;
- Kultivimi i agrumeve, rreth 400.000 pemë ose 600 ha;
- Kultivimi i ullinjve, mbjelljet e vjetra - rreth 80.000 pemë ose 300 ha, dhe mbjelljet e reja intensive - rreth 70.000 pemë ose 300 ha;
- Fruta të tjera, fiq, shegë, kivi, etj., rreth 250 ha;
- Prodhimi i vreshtave, rreth 95 ha.

Potenciali tokësor - dallohen tre komplekse fushore: Ulqini dhe fusha e Shtojit me sipërfaqe rreth 6600 ha; Lugina e Shasit me rreth 450 ha dhe fusha e Anës së Malit me sipërfaqe bruto 2400 ha. Falë vetive të favorshme fizike, kjo tokë ofron mundësi të mira për zhvillimin e një sërë degësh bujqësore, duke filluar me prodhimtarinë intensive të perimeve, kultivimin e kulturave të ndryshme shumëvjeçare (ullinj, agrume, fiq, shegë, hardhi, etj.), duke përfunduar me prodhimin blegtoral. Këto zona, me ujitje të siguruar, kanë potencial të konsiderueshëm bujqësor, i cili është shfrytëzuar shumë pak.

Për gjendjen aktuale të sektorit të peshkimit dhe gjuetisë, vetëqeverisja lokale nuk ka informacione. Gjithashtu nuk ka një regjistër të trashëgimisë tradicionale në prodhimin bujqësor dhe prodhimin ushqimor. Krahas regjistrimeve dhe planifikimeve të dobëta, është regjistruar një nivel i ulët i njohurive dhe ndërgjegjësimit të sektorit në nivel shtetëror, përfshirë drejtimet strategjike, si dhe këshillime joadekuate/inekzistente në bujqësi në nivel lokal, nivel i ulët i njohurive në fushën e tërheqjes së fondeve shtetërore, numri i pamjaftueshëm/i vogël i punonjësve, marketingu negativ, promovimi i pamjaftueshëm i praktikave të mira.

Dokumentet strategjike, planifikuese, programet, vendimet e tjera nuk janë të harmonizuara, shumë shpesh në kolizion me dokumentet kombëtare. Gjendja faktike aktualisht është e tillë që

“kërcënohet” zhdukja e prodhuesit “të vogël” dhe ekonomisë bujqësore si shtyllë kryesore e zhvillimit dhe diversifikimit të sektorit bujqësor.

Parlamenti Europian, përmes Komitetit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, miratoi propozimin për një rezolutë për të ardhmen e prodhuesve të vegjël bujqësorë (2013/2096 INI), e cila i jep rëndësi të veçantë zhvillimit dhe ruajtjes më të fortë të fermave familjare të angazhuara në prodhimin e ushqimit. Ndër masat e ndryshme që rekomandohen, komuniteti lokal (qytetet dhe komunat) mbështet fermat bujqësore në formën e shitjes së produkteve të tyre në tregje: "inkurajon rritjen e shitjeve të drejtpërdrejta në tregjet lokale dhe rajonale, duke përfshirë produktet tradicionale, zhvillimin e thjeshtuar, format e përpunimit në ferma të vogla, duke iu përmbajtur parimeve të përgjegjësisë, por pa një sistem të përpunuar kontrolli; gjithashtu u bën thirrje qeverive territoriale të jenë më aktive në zhvillimin e infrastrukturës për shitjen e drejtpërdrejtë, duke përfshirë tregjet lokale dhe urbane, duke lehtësuar kështu aksesin e konsumatorëve në produkte bujqësore të lira, të freskëta dhe cilësore; „*konsiderohet se në zgjidhjen e problemeve të fermave të vogla, përveç politikës së përbashkët bujqësore, duhet të përfshihen politika të tjera, ndër të tjera politika e kohezionit, për të kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës teknike dhe aksesit në shërbimet publike në zonat rurale dhe është i nevojshëm financimi i aktiviteteve që kanë të bëjnë me përfshirjen sociale, arsimimin, aftësimin profesional, transferimin e njohurive; duke qenë se këto ferma nuk kanë ndikim të madh në treg, mund të lejohet mbështetje shtesë nga fondet shtetërore në përputhje me rregullat e harmonizuara me Komisionin Evropian dhe pa shkelur rregullat e konkurrencës në treg;”.*

Të gjitha këto fakte janë një sinjal se duhet t'i drejtohem plotësisht të nevojave ushqimore të popullsisë nga burimet tona natyrore dhe të përdorim të gjitha burimet në dispozicion për të nxitur prodhimin e ushqimit. Në këtë, roli i tregjeve dhe standave lokale, si pika qendrore të shitjes së produkteve vendase, veçanërisht në qytete, është i rëndësishëm.

3.2 Regjistri i njësive bujqësore (RNJB)

Regjistri i njësive bujqësore bashkon të gjithë prodhuesit bujqësorë në nivel shtetëror dhe është nën juridiksionin e ministrisë përkatëse (Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave). RNJB është baza për analizimin dhe propozimin e masave strategjike të ardhshme në nivel lokal dhe shtetëror. Në përputhje me të dhënat e regjistrit të lartpërmendur në vitin 2022, për komunën e Ulqinit janë këto të dhëna: në komunën e Ulqinit aktualisht janë të regjistruara 648 ferma, që është rreth 5% e numrit të përgjithshëm të fermave të regjistruara në Mal të Zi. Nga ky numër, 643 ferma janë në kategorinë e fermave bujqësore familjare, ndërsa pesë ferma të regjistruara janë të personave juridikë.

Tabela 4. Numri i fermave të regjistruara për komunën e Ulqinit në bazë të strukturës organizative

Struktura organizative	Numri i njësive bujqësore
Persona juridikë	5

Persona fizikë	643
Numri i njësive bujqësore të regjistruara në komunën e Ulqinit	648

Numri i grave të regjistruara që mbajnë ferma është 52, që është shifër shumë e ulët në krahasim me atë të burrave. Numri i anëtarëve të regjistruar të fermave bujqësore në territorin e gjithë komunës është 749, që tregon një gjendje shumë të pafavorshme, kur krahasohet në numrin total të fermave të regjistruara.

Struktura moshore e pronarëve të fermave familjare në komunën e Ulqinit është paraqitur në tabelën 5. në vijim.

Tabela 5. Struktura moshore e pronarëve të fermave familjare në komunën e Ulqinit

Mosha e pronarëve	Numri i pronarëve
Më të rinj se 20 vjet	2
Në mes 20 dhe 30 vjet	17
Në mes 30 dhe 40 vjet	59
Në mes 40 dhe 50 vjet	126
Në mes 50 dhe 60 vjet	199
Në mes 60 dhe 70 vjet	172
Më të moshuar se 70 vjet	68

Në RNJB regjistrohen të dhënat për nivelin e arsimimit si të mbajtësve ashtu edhe të anëtarëve të fermave familjare. Të dhënat për nivelin e arsimimit të pronarëve të fermave familjare janë paraqitur në tabelën 6.

Tabela 6. Struktura arsimore e pronarëve të fermave familjare në komunën e Ulqinit

Arsimimi i pronarëve	Numri i pronarëve
Shkolla fillore e papërfunduar	40
Shkolla fillore	135
Shkolla e mesme	350
Shkolla e lartë	42
Fakulteti	76

Të dhënat për tokën bujqësore dhe kulturat e përdorura regjistrohen gjithashtu në RNJB dhe janë paraqitur në tabelën 7. në vijim:

Tabela 7. Sipërfaqet nën kultivim në komunën e Ulqinit

Lloji i kulturës	Sipërfaqja (ha)
Molla	0,16
Kajsi	1,18
Kivi	0,69
Trangull	1,66
Patate, të vonshme	1,63
Patate, të hershme	7,48
Dardha	0,97
Misër	24,79
Misër për masë të gjelbër	11,63
Manaferrë	0,07
Lakra	0,47
Limon	1,73
Perime me gjethe	5,89
Livadhe	349,02
Shalqi	44,74
Jonxhë	15,18
Mjedër	0,28
Mandarina	119,42
Ullinj	110,40
Të përziara/Të tjera	18,35
Shega	22,46
Arra	0,06
Fidanë tjerë	1,52
Citrusë tjerë	2,81
Perime dhe lakra të tjera me rrënjë	0,03
Bimë të tjera foragjere për masë të gjelbër	0,87
Perime të tjera	7,72
Speca	6,24
Domate	8,64
Kullota	84,94
Fasule	0,61
Portokall	11,90
Grurë	1,58
Fidanë – pemë pyjore	1,42
Fidanë – bimë dekoruese	0,01
Karotë	0,01

Kumbull	2,03
Fik	3,66
Pyll	12,39
Tokë pjore	1,51
Qershi	0,72
Hardhia – varietetet për prodhimin e verës së kontrolluar me cilësi	1,15
Hardhitë - varietetet e tavolinës	0,68
Hardhitë - varietetet e verës	6,29
Vishnja	2,93

Tabela 8. Numri i objekteve në ferma në komunën e Ulqinit

Lloji i objektit	Numri i objekteve
objekt për mbajtjen e makinerive bujqësore, pajisjeve dhe lëndëve të para	221
objekt për mbajtjen e bagëtive	394
objekti për përpunimin e produkteve bujqësore	8
tjera	14
magazinimi i produkteve bujqësore	60
serrë me xham ose serrë me plastmasë	67
bodrum vere	4

Të dhëna të rëndësishme, të cilat regjistrohen edhe në RNJB, janë struktura e mekanizimit dhe pajisjeve në njësitë bujqësore të regjistruara dhe flasin për nivelin e pajisjeve për prodhim bujqësor efikas sot.

Tabela 9. Struktura e mekanizimit dhe pajisjeve në fermat në komunën e Ulqinit

Makina të tjera (përhapëse plehërimi, spërkatës etj.)	56
Traktorë me dy boshte deri në 40 kw (deri në 54 kf)	316
Traktorë me dy boshte nga 41 kw në 60 kw (55 kf - 82 kf)	17
Traktorë me dy boshte nga 61 kw në 80 kw (83 kf - 109 kf)	1
Traktorë me dy boshte nga 81 kw në 100 kw (110 kf – 136kf)	0
Traktorë me dy boshte mbi 101 kw (137 kf)	0
Traktorë me një bosht	296
Kamionë	14
Kombajnë	2
Makinat e përpunimit të qumështit	2

Makina mbjellëse	8
Shirës rrushi	11
Pajisjet e mjeljes	159
Pajisjet e ujitjes	76
Pajisje të tjera (plug, trinë, tharëse, etj.)	682
Makinë për sanë (presim në deng)	31
Rimorkio për traktor	306
Kositëse bari, vetëlëvizëse	9
Kositëse bari, traktor	239

3.3 Sektori i bujqësisë

Fermat bujqësore në Mal të Zi nuk janë të specializuara. Rreth 80% e të gjitha fermave bujqësore janë ferma të tipit të përzier dhe vetëm 8.0% e numrit të përgjithshëm të fermave janë (të ashtuquajtura) të specializuara, të cilat mund t'i atribuohen edhe territoreve që i takojnë komunës së Ulqinit.

3.3.1 Tokë bujqësore⁵

Si një nga pasuritë më të rëndësishme natyrore, mbulesa tokësore e Malit të Zi është shumë e larmishme, e karakterizuar nga njësi sistematike heterogjene, e cila vjen si pasojë e shumëllojshmërisë së kushteve të formimit të tij: nënshtresa mëmë të vetive të ndryshme gjeologjike dhe litologjike, forma të theksuara të relievi, ndryshueshmëria e kushteve klimatike dhe mënyrat e përdorimit. Tokat mbizotëruese janë me pjellori modeste, reaksion acidik, përbërje mekanike më të lehtë, shpesh skeletore dhe të cekëta, gjë që rezulton në një kompleks absorbues të ulët, dhe për rrjedhojë një aftësi të ulët për të mbajtur lagështinë dhe lëndët ushqyese.

Sipërfaqja e tokës bujqësore në Mal të Zi është 309,241 ha, që përfaqëson 22.4% të territorit të Malit të Zi.

Tabela 10: Toka bujqësore sipas kategorive (në hektarë)

Toka bujqësore sipas kategorive të përdorimit	2013
Tokë në dispozicion	309.241
<i>a) kopshtet</i>	1.992,1
<i>b) tokat e lëvrueshme</i>	5.812,1
<i>c) pemishtet (përfshirë ullishtat)</i>	1.974,9
<i>d) vreshtat</i>	2.701,8
<i>e) fidanishte</i>	32,1


⁵ Shumica e informacionit është marrë nga Strategjia për Zhvillimin e Prodhimit të Ushqimit dhe Zonave Rurale 2015–2020

Livadhe dhe kullota shumëvjeçare	210.618,0
Totali i tokës bujqësore të përdorur	223.131,0

Burimi: MONSTAT, Të dhënat statistikore në vitin 2014.

Nga kjo sipërfaqe, 95.2% i përket fermave familjare bujqësore dhe pjesa tjetër, që përfaqëson 4.8%, i përket subjekteve afariste. Ferma mesatare ka 4.6 ha tokë bujqësore të përdorur. Pjesa e madhe e sipërfaqeve të papërpunuara është konsekuencë e pjesëmarrjes së madhe të kullotave në sipërfaqen totale të tokës bujqësore në Mal të Zi. Nisur nga sipërfaqja dhe struktura e tokës bujqësore, me 0,49 ha tokë bujqësore për banor, Mali i Zi bën pjesë në grupin e vendeve evropiane me burime toke të favorshme për zhvillimin e bujqësisë. Grafiku i mëposhtëm tregon strukturën e tokës bujqësore në Mal të Zi në vitin 2014.

Grafiku 1: Struktura e tokës bujqësore të përdorur në Mal të Zi në vitin 2013



Burimi: MONSTAT, Të dhënat statistikore për vitin 2014.

Pavarësisht burimeve të konsiderueshme të tokës, ajo është e fragmentuar dhe e shpërndarë në një numër të madh fermash familjare. Kështu, 31.6% e totalit të tokës bujqësore përbëhet nga parcela deri në 0.50 ha. Më shumë se gjysma e fermave (54.1%) përdorin 0.10 ha deri në 1 ha tokë bujqësore. Rreth 73% e fermave familjare zotërojnë sipërfaqe më pak se 2 ha, ndërsa vetëm 0.9% e fermave familjare kanë sipërfaqe toke mbi 100 ha, që përbën 38% të totalit të tokës bujqësore të përdorur. **Në rajonin e bregdetit, struktura (madhësia e fermave) është më e pafavorshme, ndërsa rajoni verior ka përqindjen më të lartë të fermave që përdorin sipërfaqe më të mëdha të tokës bujqësore.** Cilësia e tokës në Mal të Zi nga pikëpamja e monitorimit të ndotjes është e mirë, që do të thotë se toka nuk është e ndotur nga metale të rënda dhe ndotës të tjerë. Nga pikëpamja e pjellorisë së tokës, situata është e ndryshme, sepse pjesa më e madhe e saj përbëhet nga tokë të cekëta skeletore me pjellori të ulët dhe kapacitet të ulët të mbajtjes së lagështisë.

Tabela 11. Struktura e tokës bujqësore⁶ (të dhënat krahasuese: kadastri dhe MONSTAT)

Nr.	Kategoria e përdorimit të tokës	Të dhënat kadastrale	MONSTAT
1.	Tokë e lëvrueshme dhe kopshte	2.719	3.481
2.	Pemishte (gjithsej)	534	700
3.	Vreshta (gjithsej)	72	95
4.	Livadhe	2.099	2.000
5.	Hapësira të punueshme (1 + 2 + 3 + 4)	5.424	6.276
6.	Kullotë (gjithsej)	1.857	2.019
7.	Kallamishte dhe pellgje	242	242
8.	Zonat bujqësore	7.523	8.537
9.	Tokat pyjore	6.322	5.900
10.	Jopjellore	690	600
11.	Gjithsej (8+9+10)	14.535	15.037

Problemet kryesore në lidhje me tokën në Mal të Zi lidhen me sa vijon:

- Ndryshimi i dedikimit të tokës - para së gjithash, i referohet urbanizimit, ndërtimit të objekteve industriale dhe objekteve të tjera të infrastrukturës. Ky problem është i dukshëm pranë vendbanimeve, luginave, rreth rrjedhave të lumenjve dhe në rajonin e bregdetit. Shifra të sakta për konvertimin e tokës nuk janë të disponueshme, por ne po i japim të dhënat, për hir të ilustrimit. Niveli i ndërtuar i zonës bregdetare (1 km nga deti) aktualisht është 13.8%, që është mesatarja në 38 vende evropiane. Megjithatë, nëse marrim parasysh ndërtimet e planifikuara (planet hapësinore tashmë të miratuara), atëherë kjo shifër arrin pothuajse 46.5%, që është dukshëm më e lartë se në shumicën e vendeve evropiane, me përjashtim të Belgjikës, e cila ka një shkallë të lartë të dendësisë së popullsisë;
- Degradimi i tokës nëpërmjet shfrytëzimit të lëndëve të para minerale (zhavorr, rërë, xehe të ndryshme);
- Rritja e përqendrimit të substancave toksike (inorganike dhe organike) - kryesisht rezultat i depozitimit joadekuat të mbetjeve komunale dhe industriale ose emetimeve të gazrave të shkarkimit pranë rrugëve kryesore;
- Procesi i erozionit po bëhet gjithnjë e më shumë pasojë e menaxhimit të pakoordinuar të tokës dhe humbjes së biodiversitetit, si dhe moszbatimit të masave në lidhje me parandalimin e erozionit;
- Të dhëna të pamjaftueshme në kadastrë.

Thelbi i këtyre problemeve përbëhet nga disa trende e procese:

- Tendencat demografike – braktisja e zonave rurale dhe migrimi në zonat urbane (që nënkupton edhe braktisjen e mënyrës tradicionale të përdorimit të tokës, për shkak të së cilës, përmes procesit ekologjik të sukcesionit, toka bujqësore humbi ose u kthye në pyll);
- Menaxhimi i dobët i tokës - sistemi i menaxhimit të tokës është i pazhvilluar (nuk ka politikë adekuate të tokës), mungojnë informacionet dhe të dhënat statistikore nga

⁶ Burimi: Plani Zhvillimor Strategjik i Komunës së Ulqinit për periudhën 2016-2020

terreni, monitorimi dhe kapacitetet adekuate njerëzore dhe teknike. Ky është një kufizim serioz nëse merret parasysh se një pjesë e konsiderueshme e tokës bujqësore është në pronësi të shtetit, e cila mund t'u jepet me qira investitorëve të interesuar.

Tregu i qirasë së tokës bujqësore është ende i pazhvilluar, para së gjithash për problemin e mentalitetit në zgjidhjen e marrëdhënieve pronësore-juridike të tokës së trashëguar. Bankat e pranojnë tokën si garanci (hipotekë) me rastin e miratimit të kredive, por kur bëhet fjalë për tokën bujqësore, vlera e saj zvogëlohet për shkak të moszhvillimit të tregut të tokës bujqësore. Përrjashtim bëjnë tokat në zonën bregdetare ose parcelat në zonën urbane, në një vendndodhje të mirë, e cila mund të përdoret për ndërtimin e objekteve të banimit.

Përderisa përdorimi adekuat i burimeve të tokës në dispozicion është i një rëndësie të madhe për zhvillimin e bujqësisë në Mal të Zi, shumica e çështjeve të lartpërmendura kërkojnë veprime të përbashkëta dhe koordinim të institucioneve në nivel kombëtar dhe lokal.

3.3.2 Blegtoria

Spektori i blegtorisë së Ulqinit karakterizohet me konkurrencë relativisht të ulët. Rajonet më të rëndësishme për prodhimin e gjedhit janë aktualisht komunat në veri. Kjo është pasojë e strukturës së pafavorshme ekzistuese (kryesisht ferma të vogla, familjare), nivelit të ulët teknik të mbarështimit të blegtorisë, etj.

Sipas të dhënave të Drejtorisë për Shërbime Këshillimore në Industrinë Blegtorale, në vitin 2020, më shumë se dy krerë lopë dhe mëshqerra mbahen në 4,846 ferma bagëtish, me një numër të përgjithshëm prej 35,686 krerë. Tabela jep një pasqyrim të pronarëve dhe numrit të përgjithshëm të krerëve në këto ferma.

Tabela 12: Numri i pronarëve dhe krerëve në fermat e bagëtive me dy ose më shumë krerë

Numri rendorë	Komuna	Nr. pronarëve	Nr. i krerëve
1	Tivar	54	426
2	Ulqin	146	1048
3	Tivat	1	3
4	Herceg Novi	25	137
5	Kotorr	11	114
6	Budve	1	8
7	Podgoricë	305	2409
8	Danillovgrad	142	1287
9	Cetinë	44	581
10	Nikshiq	738	6074
11	Plluzhinë	233	1649
12	Shavnik	187	1328
13	Beranë	274	1642
14	Andrijevicë	94	541
15	Rozhajë	298	2597
16	Petnjicë	152	1314
17	Plavë	110	779
18	Guci	41	319
19	Bijello Pole	802	6155
20	Kollashin	148	955

21	Mojkovac	167	991
22	Plevla	748	4426
23	Zhablak	125	903
	GJITHSEJ	4846	35686

Në përputhje me të dhënat nga Strategjia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Zonave Rurale (2015–2020), prodhimi i qumështit në Mal të Zi bazohet kryesisht në prodhimin e qumështit të lopës, ndërsa sasi të qumështit të deles dhe dhisë janë dukshëm më të vogla.

Për të përmirësuar konkurrencën e sektorit të blegtorisë, të gjithë nënsektorët (gjedhët, delet dhe dhitë) kanë nevojë për mbështetje më intensive për investime, veçanërisht nga administrata lokale. Pa akses të lehtë në burimet e parave nga bankat komerciale dhe pa mbështetjen e duhur nga fondet shtetërore dhe lokale në formën e granteve, do të jetë e vështirë të sigurohet zhvillimi i fermave blegtorale.

3.3.3 Prodhimi bimor

Prodhimtaria bimore në Ulqin shquhet për një numër të madh të fermave të vogla bujqësore që kultivojnë kultura të ndryshme bimore, dhe përveç bujqësisë merren edhe me turizëm. Kushtet e favorshme natyrore mundësojnë kultivimin e agrumeve dhe pemëve kontinentale, si dhe pothuajse të gjitha llojeve të perimeve.

Sipas të dhënave nga RNJB, pjesa më e madhe e fermave merret me prodhimin e pemëve dhe perimeve.

Pemishtet zinin një sipërfaqe prej 1,856.1 ha në vitin 2013, që është 27.7% më shumë se sa zënë sipas regjistrimit të vitit 2010.

Sipas të dhënave nga Studimi sektorial për frutat dhe perimet (2014), peshën më të madhe e ka prodhimi i agrumeve (24.4%) dhe kumbullave (24.2%). Agrumet janë pema më e zakonshme e rajonit jugor dhe në strukturën e tyre peshën më të madhe e zënë mandarinat, të cilat kultivohen në një masë të konsiderueshme në plantacione. Përveç pjeshkës, mjedrës, luleshtrydheve dhe agrumeve, speciet e tjera frutore kryesisht rriten gjerësisht pa aplikimin e masave agroteknike (mihje, plehërim, krasitje, mbrojtje kundër dëmtuesve dhe ngricave, ujitje, etj.).

3.3.4 Pemëtaria dhe kultivimi i perimeve

Rendimentet dhe sasi të cilët realizohen (qoftë në pemëtari, qoftë në kultivimin e perimeve) në Ulqin, sipas të dhënave nga RNJB, janë më të ulëta në masë të konsideruar kundrejt potencialit të sektorit. Arsyeja është zakonisht një përzgjedhje joadekuate e varieteteve dhe hibrideve dhe aplikimi joadekuat i masave agroteknike, por edhe mungesa e mekanizimit. Plantacionet me pemë janë të përfaqësuara në mënyrë të pamjaftueshme, veçanërisht sa i përket pemëve kontinentale. Prodhimi me serre, gjithashtu.

Me çmime të larta të inputeve dhe teknologji tradicionale të prodhimit, sektori i pemëve-perimeve është përgjithësisht jo konkurrues si në tregun vendas ashtu edhe në atë të jashtëm. Përrjashtim bëjnë agrumet, ku Ulqini mund të jetë lider në vend për sa i përket prodhimit të tyre. Për më tepër, pemët dhe perimet e prodhuara zakonisht nuk i plotësojnë standardet e tregut.

Produktet e pa standardizuara ofrohen në tregje, pa deklarime, në ambalazhe joadekuate (zakonisht të ripërdorura).

Problemet më të rëndësishme me të cilat përballen prodhuesit e pemëve-perimeve janë marketingu i çorganizuar dhe mungesa e fondeve për të zgjeruar prodhimin. Ata gjithashtu nuk kanë njohuri për teknologjitë moderne. Në përgjithësi, ata janë të dobët në asocim dhe pikërisht mungesa e formave cilësore të shoqërimit, të cilat mund të tejkalojnë problemet kryesore, është një nga dobësitë kryesore të sektorit. Infrastruktura e dobët (kryesisht rrugët), veçanërisht në zonat rurale, gjithashtu kufizojnë zhvillimin e sektorit.

Përpunimi i pemëve dhe perimeve është shumë dobët i zhvilluar, pavarësisht potencialit të madh dhe traditës së gjatë në prodhimin e pekmezeve, xhemëve, ëmbëlsirave, lëngjeve, shurupeve, pemëve dhe perimeve të thata etj.

Çmimet e pemëve dhe perimeve në Ulqin janë mjaft të larta. Një nga karakteristikat është ndryshueshmëria e theksuar gjatë sezonit. Çmimet e pemëve dhe perimeve të importuara shpesh janë më të ulëta se ato vendase dhe duke qenë se kërkesa është kryesisht e orientuar drejt çmimeve, prodhuesit vendas shpesh mbeten “jashtë lojës”. Varësia nga importi në këtë sektor po bëhet gjithnjë e më e theksuar në Ulqin.

Ndryshimet në zakonet e blerjeve reflektohen edhe në tregun e pemëve-perimeve dhe blerjet në treg ua lënë vendin supermarketeve, ku pemët dhe perimet vendase janë më pak të përfaqësuara. Arsyeja qëndron kryesisht në pamundësinë e prodhuesve vendas për të siguruar sasinë e nevojshëm dhe vazhdimësinë e furnizimit të zinxhirëve të shitjes me pakicë.

3.3.5 Ekonomi bujqësore

Pavarësisht se prodhimi në terren paraqet një nga degët më të rëndësishme bujqësore për sa i përket shfrytëzimit të tokës dhe prodhimit për ushqim për njerëz dhe kafshë, si dhe kontribut në bujqësinë e përgjithshme, duke analizuar të dhënat nga RNJB, mund të konstatojmë se është pothuajse plotësisht i pazhvilluar në Ulqin.

Spektori i prodhimit primar të bimëve karakterizohet nga disa dobësi të përbashkëta:

fragmentimi i prodhimit, integrimi i dobët vertikal, sasia e vogël e prodhimit, niveli i ulët teknologjik, raporti i pabarabartë cilësi-çmim, çmimi i lartë i prodhimit për njësi dhe mungesa e kapaciteteve ruajtëse.

Me parakushte të mira natyrore (klimë, tokë të pandotur, hidropotencial), Ulqini ka një potencial të jashtëzakonshëm për prodhimin e frutave dhe perimeve të cilësisë së lartë, veçanërisht agrumeve, fiqve, shegëve, ullinjve, hardhive, bamjeve, bimëve mjekësore dhe aromatike. Megjithatë, zhvillimi i sektorit kufizohet shumë nga teknologjia e prodhimit dhe mungesa e inovacionit. Periudha e ardhshme duhet shfrytëzuar dhe sektori i pemëve-perimeve duhet bërë më konkurrues dhe i gatshëm për të ndjekur trendet e praktikës moderne bujqësore.

3.3.6 Ullishtaria

Pema e ullirit është kultura më e vjetër subtropike në bregdetin malazez, me një traditë në rritje prej më shumë se 2000 vjetësh. Ullishtaria është një nga degët më të zhvilluara bujqësore në Ulqin, veçanërisht po te kemi parasysh plantacionet e ullirit në Gjirin e Valdanos. Pjesa më e

madhe e ullishtave janë plantacione të vjetra (rreth 70%, me vjetërsi mesatare 200-300 vjeç), të cilat ndodhen në zona më pak të aksesueshme, kurse vitet e fundit është krijuar edhe prodhimi më pak i zakonshëm në plantacione. Numri i pemëve të ullirit në Mal të Zi është 489,520, dhe në dhjetë vitet e fundit ka shënuar rritje të vazhdueshme (ndër të tjera, falë zbatimit të masave agro-buxhetore, qëllimi i të cilave është ngritja e plantacioneve të reja, si dhe rindërtimi dhe rivitalizimi i plantacioneve ekzistuese). Varietetet më të përfaqësuara vendase janë vajuku (65%), *crnica*, *sitnica*, *lumbardeška* dhe *drobnica*. Viteve të fundit vërehet trendi i mbjelljes së varieteteve siç janë *Picholine*, *Arbequina*, *Leccino*, *Coratina*. Këto varietete duhet të zëvendësojnë mungesën e varieteteve në sortimentin vendas dhe të mundësojnë kultivimin e ullirit në zonat të cilat, për arsye të ngricave të dimrit, janë kritike.

Në Mal të Zi, nuk ka sipërfaqe të mëdha të ullinjve në pronësi private (vetëm 12 ferma familjare zotërojnë 6 ha), por dominojnë pronat më të vogla. Komplekse më të mëdha ekzistojnë në zonën e Lushticës, me 20.000 pemë dhe në Ulqin, në Valdanos, me 18.000 pemë. Ulqini duhet ta shfrytëzojë këtë avantazh krahasues për të zhvilluar sektorin. Gjiri i Valdanosit ndodhet 4 km në veriperëndim të Ulqinit. Ullishta e vjetër në Valdanos, me 18 000 pemë, është pjesë e një kompleksi më të madh, i cili shtrihet deri në qytetin e Ulqinit. Mosha e këtyre pemëve është deri në 2000 vjet, por ka të tilla që kanë ekzistuar që nga periudha e Greqisë antike. Kultivimi i ullirit karakterizohet nga ndryshime të theksuara në rendimentet vjetore (nga 300 ton ullinj në vit në vitet e vjeljes së dobët, në 2600 ton ullinj në vitet rekord të frytshëm). Një nga arsyet është zbatimi joadekuat, i parregullt dhe jo i plotë i masave agroteknike. Gjegjësisht, lartësia mesatare e pemëve në Mal të Zi është 7-10 m, e në disa raste deri në 15 metra, gjë që e bën të pamundur ushtrimin e masave adekuate agroteknike dhe e vështirëson grumbullimin pas shkundjes së ullinjve.

Prodhimi organik i ullirit në Ulqin është plotësisht i pazhvilluar, megjithëse ka potencial të madh për zhvillimin e tij në disa lokalitete të izoluara (p.sh. Valdanos). Aktualisht, në territorin e komunës së Ulqinit nuk ka asnjë prodhues organik të regjistruar.

Industria përpunuese në Mal të Zi nuk është modernizuar dhe nuk është e harmonizuar sa duhet me standardet ndërkombëtare të prodhimit të ullirit dhe vajit të ullirit, gjë që ndikon edhe në cilësinë e produktit final. Vitet e fundit, megjithatë, janë vënë re zhvillime të rëndësishme, si në aspektin agroteknik ashtu edhe në teknologjinë e përpunimit të frutave të ullirit.

Fryti i ullirit kryesisht përpunohet në vaj (90%), dhe një pjesë e vogël ruhet për përdorim shtëpiak. Në Mal të Zi janë të regjistruara 15 mullinj vaji, tetë prej të cilave kanë linjë të vazhdueshme për vajin e presimit të ftohtë (kapaciteti 250-500 kg fruta në orë), dhe pjesa tjetër janë mullinj tradicionalë me presa guri. Rendimenti varion nga 300 ton ullinj në vit, në vitet e vjeljes së dobët, në 2600 ton ullinj në vitet e frytshme dhe rekorde.

Sasia e produkteve të tjera të prodhuara nga frutat e ullirit është e papërfillshme dhe prodhohet kryesisht për nevoja personale dhe në mënyrë tradicionale. Ka dy fabrika më të vogla për prodhimin e sapunit të vajit të ullirit dhe një për prodhimin e likerit të ullirit. Ulliri ka përdorime të shumta: mund të përdoret për të bërë produkte kozmetike, suvenire nga pemët e ullirit, mobilje më të vogla, çaj me gjethe ulliri etj. Për të valorizuar këtë potencial, është e nevojshme

promovimi i formave të ndryshme të asocimit (kooperativat, organizatat e prodhuesve, etj.), të cilat do të përvetësonin në mënyrë adekuate inputet dhe do të tregtonin produktin përfundimtar.

3.3.7 Vreshtaria

Përkundër potencialit të madh, për shkak të kushteve tokësore dhe klimatike, vreshtaria dhe prodhimi i verës janë të pazhvilluara në Ulqin. Ndonëse në të dhënat e administratës vendore thuhet se prodhimi i vreshtarisë është i pranishëm në rreth 95 ha, të dhënat nga RNJB regjistrojnë vetëm 8 ha. Një arsye e mundshme është prodhimi jashtë kuadrit rregullator.

3.3.8 Peshkataria

Peshkimi është një degë tradicionale ekonomike në Mal të Zi. Ai përfshin peshkimin (peshkimi tregtar në ujërat e peshkimit të Malit të Zi, në zonën e peshkimit në bregdet dhe në Liqenin e Shkodrës, peshkim sportiv-rekreativ, shkencor-kërkimor, rehabilitues dhe selektiv), akuakulturën (akuakulturë e ujërave të ëmbla dhe marikulturë), tregu i përpunimit të peshkut dhe produkteve të peshkimit. Drejtoria e Peshkimit është një organ i administratës shtetërore i ngarkuar me zhvillimin dhe zbatimin e politikës së peshkimit. Detyrat e Drejtorisë përfshijnë hartimin dhe propozimin e projekt-rregulloreve, si dhe hartimin e buxhetit vjetor. Aktet ombrellë ligjore që rregullojnë fushën e peshkimit dhe akuakulturës janë Ligji për Peshkimin Detar dhe Marikulturën dhe Ligji për Peshkimin dhe Akuakulturën e Ujërave të ëmbla, me rregullore shoqëruese, të nxjerra nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë Ujore.

Sasia totale e peshkut të kultivuar dhe të kapur e regjistruar nga MONSTAT, në periudhën 2017–2019, varionte ndërmjet 1,999 (2017) dhe 2,298 ton (2018) peshk, guaca, cefalopodë dhe gaforre (duke përfshirë peshkimin në Liqenin e Shkodrës). Nëse sasia e deklaruar e peshkut të rritur dhe të kapur, e cila është e regjistruar në MONSTAT, pjesëtohet me numrin e banorëve, të dhënat e përfutuara rezultojnë se janë rritur dhe kapur 3.08 deri në 3.69 kg peshk dhe organizma të tjerë ujorë për frymë banori.

Peshkimi prej qindra vitesh është pjesë e jetës së popullatës vendase, e cila përfiton nga bollëku i peshkut si në deltën e Bunës ashtu edhe në det të hapur. Peshkimi mbetet një aktivitet i rëndësishëm ekonomik, i rëndësishëm për turizmin dhe në Ulqin më së shpeshti kryhet në këto lokacione:

Lumi Buna dhe Port Milena.

Peshkimi ka qenë një aktivitet i rëndësishëm tradicional në fshatrat Reç, Sutjel dhe Shën Gjergj. Deltat e Bunës dhe e Port Milenës janë shumë të pasura me ngjala dhe qefull. Megjithatë, që nga mbyllja e kufirit me Shqipërinë, qasja në lumë dhe brigjet e tij ishte ndaluar rreptësisht. Madje, për shkak të ndërtimit të digës në Drin, Buna humbi një pjesë të ujit, ndërsa në të njëjtën kohë në rrjedhën e sipërme të Shkodrës, ndotja u rrit ndjeshëm. Si rezultat, peshkimi në lumenj ra. Veçanërisht duhet përmendur aktivitetet tradicionale të peshkimit me rrjeta "kalimera" në Port Milenë, ish-derdhjen e Lagunës së Zogajve dhe kullimin aktual nga Kriporja e Ulqinit. Ky kanal ujqor është veçanërisht i pasur me peshq. Megjithatë, sasia dhe cilësia e peshkut kërcënohen nga ndotja e madhe dhe peshkimi i paligjshëm.

Liqeni i Shashit

Pas Luftës së Dytë Botërore, kooperativa bujqësore në fshatin Katerkollë përdori Liqenin e Shashit. Peshkimi ishte sezonal dhe kryhej me pak mjete, kryesisht rrjeta. Varej nga faktorë të ndryshëm, si migrimi i peshkut, shumëzimi ose qëndrimi i peshqve në disa pjesë të liqenit. Ishte i përshtatur me karakteristikat ekologjike të llojeve të veçanta të peshkut, thelbësore për praninë e peshqve në zonën bregdetare. Bollëku i peshkut ishte i rëndësishëm për institucionet vendase dhe ndërkombëtare dhe investitorët e mundshëm në prodhimin intensiv të peshkut (ngjalë, krap kinez, krap, troftë, salmon).

Deti Adriatik

Peshkimi në det bëhet kryesisht në Plazhin e Vogël dhe pranë restoranteve në urën që lidh me ishullin Ada e Bunës. Është zhvilluar në nivelin e bizneseve të vogla të peshkatarëve vendas dhe pronarëve të restoranteve. Për shkak të varkave të vogla, kapja është e vogël. Pavarësisht se kapacitetet e specieve komerciale janë mjaft të shterura, ka ende mjaftueshëm për nevoja lokale. Mirëpo, peshkimi ilegal kryhet përgjatë plazheve, që dëshmohet nga rrjetet e peshkatarëve përgjatë plazheve në Adën e Bunës dhe Plazhin e Madh. Përveç peshkut, të rëndësishme janë edhe speciet cilësore të cefalopodëve, siç janë: *Largo Vulgaris*, *Sepia Ofcinalis*, *Sepiola Roundeleti* dhe *Elefone Mostchata*

Peshkimi në ujëra të ëmbla bëhet përmes peshkimit dhe kultivimit të peshkut në ujë të ëmbël - akuakulturës së ujërave të ëmbla.

Sipas Ligjit për Peshkim dhe Akuakulturë të Ujërave të Ëmbla, ujërat e peshkimit janë ujërat e lumenjve, ujërat e pasme të lumenjve, liqeneve natyrore dhe artificiale, pellgjeve, kanaleve, përrenjve, rezervuarëve dhe ujërave të tjera në të cilat jetojnë peshqit dhe organizmat e tjerë ujorë dhe të cilat përdoren për peshkim sportivo-rekreativ, me përjashtim të ujërave në vendpushimet, rezervuarët, liqenet ose ujërat rrjedhëse që përdoren ose janë të parashikuara me dokumente të planifikimit hapësinor për furnizim publik me ujë.

Lumenjtë që derdhen në det pushojnë së qeni ujëra peshkimi në pikën ku uji bëhet përgjithmonë i kripur. Në ujërat e peshkimit, zonat e peshkimit janë të përcaktuara për peshkim komercial.

Peshkimi mund të jetë sportiv-rekreativ, shkencor-kërkimor, përmirësues dhe selektiv dhe ekonomik. Peshkimi sportiv-rekreativ mund të kryhet vetëm nga persona fizikë që kanë licencë për të ushtruar peshkim sportiv-rekreativ. Peshkimi kërkimor shkencor në ujërat e peshkimit mund të kryhet nga institucione shkencore vendase dhe të huaja që plotësojnë kushtet e përcaktuara me Ligjin për peshkimin dhe akuakulturën e ujërave të ëmbla. Peshkimi përmirësues është peshkimi që kryhet për të shpëtuar peshqit dhe organizmat e tjerë ujorë nga ngordhja ose shkatërrimi në një ujë të caktuar peshkimi. Peshkimi selektiv është peshkimi që kryhet për të mbrojtur speciet vendase të peshqve dhe organizmave të tjerë ujorë. Peshkimi tregtar bëhet vetëm në zonën e peshkimit me ose pa mjet lundrimi, bazuar në licencën e peshkimit tregtar.

Llojet kryesore në peshkimin tregtar në det janë sardelet (*Sardina pilchardus*), me një peshë prej 26,2% në totalin e ngarkesës, të ndjekur nga açugat (*Engraulis encrasicolus*), me 15,7%, toni

(*Thunnus thynnus*) me 6,8%, skumbri (*Trachurus trachurus*) me 5,5%, dhe nga speciet demersale - karkaleci (*Parapenaeus longirostris*) dhe merluci (*Merluccius merluccius*), me 3,7 dhe 3,9%, si dhe barbunit (*Mullus barbatus*) me 3,6% pjesëmarrje në totalin e ngarkesës (për periudhën 2017-2019). Peshkimi në Detin Adriatik kryhet duke përdorur anije peshkimi.

Akuakultura e ujërave të ëmbla është e reduktuar vetëm në kultivimin e llojeve të peshqve të ujërave të ftohtë, me dominimin absolut të troftës (*Oncorhynchus mykiss*). Përveç troftës, pjesëmarrja e llojeve të tjera (trofta e rrjedhës së Detit të Zi - *Salmo labrax*, salmoni i Danubit - *Hucho hucho*; gri - *Thymallus thymallus*) është sporadike, dhe kultivohen kryesisht për qëllime të grumbullimit të ujërave të hapura.

Numri më i madh i anijeve që marrin pjesë në peshkim në det është i regjistruar në Komunën e Ulqinit (58 mjete lundruese, ose 21.6% e numrit të përgjithshëm). Bëhet fjalë për mjete lundrimi që përdorin mjetet e vogla të peshkimit bregdetar, kryesisht rrjeta dhe *parangallë*. Në këtë zonë nuk ka asnjë mjet lundrues të regjistruar që përdor rrjeta (*peshkarexha*, shënim i përkthyesit). Flota malazeze e peshkimit karakterizohet nga vjetërsia e madhe e mjeteve lundruese, si dhe gjatësia e vogël mesatare e mjeteve. Vjetërsia mesatare e të gjitha anijeve të flotës është 31.86 vjet, ndërsa gjatësia mesatare e të gjitha mjeteve lundruese në flotë është 7.12 metra.

Në territorin e komunës së Ulqinit, në Kepin e Gjeranës, kanë filluar aktivitetet për përgatitjen e të gjitha parakushteve të nevojshme për ndërtimin e portit të peshkimit. Në portet ekzistuese mungojnë hapësirat e magazinimit të peshkut me pajisje përcjellëse (dhoma ftohëse, makina akulli, ujë), me përjashtim të Portit të Tivarit. Gjatë muajve të verës, kur portet ekzistuese e orientojnë aktivitetin e tyre drejt turizmit, çmimet e ankorimit të anijeve rriten në masë të madhe.

Aktiviteti zhvillimor prioritar i Malit të Zi është turizmi, që shpesh krijon konflikte sa i përket përdorimit të bregdetit dhe detit me peshkimin detar. Duke pasur parasysh shtrirjen e dobët të bregdetit dhe pak vende për të lidhur anijet e peshkimit dhe për të asgjësuar materialin e peshkimit, peshkatarët shpesh s'postohen, veçanërisht gjatë muajve të verës. Për të kapërcyer konfliktet, është e nevojshme të forcohet lidhja midis peshkimit dhe turizmit, të promovohet peshkimi dhe të paraqitet si një atraksion turistik dhe traditë e Malit të Zi.

Turizmi ka një ndikim të madh në peshkim për sa i përket kërkesës së tregut për peshk. Gjatë verës ka një kërkesë të madhe për produkte të freskëta nga deti, produkte me origjinë ulqinake, dhe ka interes të madh për zhvillimin e turizmit rekreativ.

Në ujërat e Malit të Zi si zonë detare e mbrojtur u proklamua zona Platomuni, kurse janë propozuar dy zona të tjera (Katiç dhe Ulqini i Vjetër).

3.3.9 Gjuetia

Gjuetia kryesisht zhvillohet në Kriporen e Ulqinit dhe Plazhin e Madh, në habitatet kryesore të shpendëve të rrallë, ndërsa ishulli Ada e Bunës është e vetmja zonë e kontrolluar rreptësisht ku gjuetia është e ndaluar. Gjuetia organizohet dhe realizohet nga ndërmarrja lokale e gjuetisë nga Ulqini, e cila ka 17 punëtorë dhe rreth 150 anëtarë vendorë (të cilët kanë leje).

Gjuetia zhvillohet ndaj zogjve, në masë më të madhe. Është një aktivitet shumë i përhapur dhe kryhet si nga gjuetarë vendas (përlllogaritet rreth 2000 njerëz) ashtu edhe nga gjuetarë të huaj (kryesisht italianë), në kënetat dhe dunat ranore bregdetare. Ligji rregullon gjuetinë, por gjuetia pa leje ndodh edhe jashtë sezonit. Sezoni i gjuetisë në Mal të Zi zgjat shumë (fillon më 15 gusht - në mes të sezonit turistik - dhe përfundon më 15 mars). Data zyrtare e mbylljes dhe/ose kufizimet e gjuetisë nuk respektohen, kështu që mund të kryhet në çdo kohë dhe në çdo vend, kryesisht gjatë migrimit të shpendëve dhe në dimër.

4. ANALIZA SWOT DHE SEKTORI I BUJQËSISË

Tabela 13: Analiza SWOT e situatës aktuale në bujqësi dhe sektorin rural

FUQITË (Strengths)	DOBËSITË (Weaknesses)
<ul style="list-style-type: none"> • Sektori i prodhimit bujqësor njihet si një nga sektorët më të rëndësishëm në kuadër të strategjive dhe programeve kombëtare të Malit të Zi; • Klima e favorshme për shumë lloje prodhimi, • Shumëllojshmëria e biodiversitetit, përfaqësimi i llojeve dhe varieteteve autoktone në bujqësi, • Kushtet e mira për prodhim organik, • Fuqia punëtore ende e mjaftueshme, e cila kërkon mundësi shtesë punësimi, • Ndryshime evidente në kuadrin institucional në periudhën e fundit • Ndryshime të dukshme pozitive në procesin e prodhimit (përshtatja e teknologjive të reja, inkuadrimi i standardeve, etj.). • Mjedisi i pandotur - tokë e pandotur për prodhim, pra për prodhim organik; • Përfaqësimi i fermave familjare me traditë të gjatë në prodhim; • Pagesa e rregullt e mbështetjes së drejtpërdrejtë nga MBPEU; • Përdorimi i teknologjisë moderne në sektorin e përpunimit; • Shumica e produkteve janë pa shtesa kimike, pesticide, aditiva etj.; • Mospërdorimi i kapaciteteve të disponueshme përpunuese; • Trendi i rritjes së subjekteve përpunuese me theks në përpunimin e produkteve bujqësore; 	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëpunimi i dobët ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe lokal dhe mospërputhja e politikave të zhvillimit bujqësor; • Fermat e fragmentuara - mbizotëron bujqësia e mbijetesës dhe rrjedhimisht biznesi joprofesional; • Fuqia punëtore e pamjaftueshme në sektor - mbizotërojnë familjet e moshuara; • Investimet e parakohshme (të vonuara) në infrastrukturë, që shkaktuan shuarjen e fshatrave (pavarësisht nga të gjitha ndërhyrjet e shtetit, “vdekja” e fshatrave malazeze është prezente); • Kushtet e pafavorshme të kreditimit - një hipotekë e madhe është e nevojshëm nëse dëshirosh të investohet në këtë sektor, sepse ekziston një mosbesim i madh i bankave ndaj fermerëve dhe ndaj investimeve të tyre; • Infrastruktura e dobët, veçanërisht në fshatrat e largëta; • Prodhimi i pakët ushqimit për bagëti; • Përbërja e dobët racore; • Objekte joadekuate për strehimin e bagëtive dhe makinerive në ferma; • Mungesa e motivimit të rinjve për t'u angazhuar në bujqësi; • Asortiment i vogël i produkteve vendase në dyqane; • Një pjesë e madhe e prodhimit realizohet jashtë blerjeve të rregullta dhe zinxhirëve blerës • Mbështetje e pamjaftueshme në investime dhe prokurim të pajisjeve përpunuese në fermat familiare me qëllim legalizimin/futjen në treg të kësaj pjese të përpunimit;

<ul style="list-style-type: none"> • Interesi i popullatës së re; • Arritja e përfitimeve të rëndësishme ekonomike nga sektori. 	<ul style="list-style-type: none"> • Konkurrencë e fortë nga importet; • Importi i produkteve me përbërje të dyshimtë; • Mungesa e njohurive dhe pajisjeve për përpunimin në ferma familjare; • Një numër i vogël i produkteve të njohura që kanë potencialin për t'u mbrojtur nga një shenjë e cilësisë; • Kontroll i pamjaftueshëm në treg; • Një numër i madh prodhuesish të vegjël, mjaft larg njëri-tjetrit, gjë që ul rentabilitetin e prodhimit; • Prodhimi kërkon shumë punë; • Njohuri të pakënaqshme në menaxhimin e prodhimit dhe prezantim adekuat të produktit; • Lidhja e pamjaftueshme horizontale dhe vertikale e aktorëve vendorë me politikën dhe shërbimet shtetërore; • Kontroll i pamjaftueshëm i cilësisë së produkteve që dalin në treg; • Shoqata e dobët e prodhuesve; • Mungesa e informacionit të konsumatorëve për rëndësinë dhe domosdoshmërinë e blerjes së produkteve të kontrolluara; • Në rajonet me potencial të madh për prodhim organik, aktualisht nuk ka prodhues organikë; • Mungesa e mbështetjes në nivel lokal; • Barrierat gjuhësore.
MUNDËSITË (<i>Opportunities</i>)	RREZIQET (<i>Threats</i>)
<ul style="list-style-type: none"> • Konsolidimi i ekonomive bujqësore; • Shoqata e prodhuesve për prodhim, përpunim dhe tregtim më efikas të produkteve; • Lidhjet më të mira ndërmjet pjesëmarrësve në zinxhirin e vlerës do të çojnë në krijimin e vlerës së shtuar më të madhe të produkteve të qumështit; • Përmirësimi i infrastrukturës (rrugëve rurale) me qëllim të përmirësimit të prokurimit; • Rikthimi i të rinjve në fshat me ndihmën e administratës lokale dhe strategjisë shtetërore dhe programeve dhe politikave të saj; • Prodhimi i organizuar bujqësor në zonat rurale që nuk përfshihet në blerje; • Legalizimi i prodhimit dhe përcaktimi i mbështetjes për përpunim në ekonomitë bujqësore; 	<ul style="list-style-type: none"> • Braktisja e fshatrave - dalje e mëtejshme e fuqisë punëtore nga zonat rurale, dhe rrjedhimisht rënia e prodhimit; • Ulja e prodhimit bujqësor; • Komunikimi i dobët me institucionet shtetërore dhe pushtetet e tjera vendore; • Mosnjohja e drejtimeve strategjike dhe programeve mbështetëse nga ana e administratës vendore; • Mungesa e shërbimit këshillimor; • Mungesa e shoqatave adekuate të prodhuesve bujqësorë dhe prodhimi i paorganizuar dhe joefikas; • Vjetërsimi i pajisjeve të prodhimit • Sfidat e tregut të lirë - konkurrencë e madhe nga produktet e huaja; • Konkurrenca e pandershme e importit, mungesa e mbrojtjes së produkteve vendase në treg; • Mbështetje e pamjaftueshme në integrimin e aktorëve përgjatë zinxhirit vertikal të vlerës; • Rënia e fuqisë blerëse të popullsisë;

<ul style="list-style-type: none"> • Prodhimi i produkteve tradicionale të cilësisë së lartë në fermë; • Mbështetje për përpunime të vogla me qëllim ruajtjen e produkteve autentike (metodat e prodhimit - recetat) për shkak të kërkesave në rritje të tregut për produkte cilësore autentike; • Mbrojtja e produktit me shenja të cilësisë; • Prodhimi organik; • Futja e programeve të reja të përpunimit me qëllim të shfrytëzimit më të mirë të kapaciteteve ekzistuese, zgjerimit të gamës së produkteve vendase dhe reduktimit të importeve; • Rritja e vlerës së shtuar të produkteve përmes përfundimit, përpunimit dhe marketingut, paketimit dhe dizajnit cilësor; • Përmirësimi i promovimit të shitjes së produkteve vendore (fushata promovuese); • Hyrja në tregun e vendeve fqinje; • Në zonat më të zhvilluara, ku prodhimi i produkteve tradicionale është më i përhapur, të zhvillohet turizmi rural; • Plasimi i produkteve në tregun vendas dhe valorizimi përmes sektorit të turizmit; • Forcimi i kapaciteteve administrative nëpërmjet formimit të shërbimeve këshillimore dhe konsulente; • Zhvillimi dhe investimi në agroturizëm, veçanërisht në fermat "të vogla" familjare. 	<ul style="list-style-type: none"> • Investime të larta për ndërtimin e fermave të reja bujqësore dhe kapaciteteve përpunuese; • Zhvillimi i përqendruar i degëve të tjera të ekonomisë - turizmit, pa zhvillimin e bujqësisë, mund të ndikojë në shpopullimin dhe nënshfrytëzimin e mëtejshëm të burimeve natyrore; • Njohuritë dhe vetëdija e pazhvilluar e prodhuesve bujqësorë; • Ndërgjegjësimi i pazhvilluar i publikut për përfitimet e produkteve vendore; • Qasje e vështirë në financa për fermerët (kredi). • Kriza ekonomike.
---	---

Sektori i bujqësisë nuk është mjaft i zhvilluar në territorin e komunës së Ulqinit. Moszhvillimi i sektorit është kryesisht për shkak të fermave të fragmentuara dhe metodave tradicionale, ekstensive të prodhimit, si dhe operacioneve joefikase dhe shfrytëzimit të pamjaftueshëm të burimeve natyrore në dispozicion. Gjithashtu, sektori përballet me mungesë të mbështetjes financiare dhe arsimore në nivel lokal.

Në nivelin e prodhimit, përveç arsyeve të përmendura, moszhvillimi i sektorit kushtëzohet edhe nga infrastruktura e dobët, për sa i përket objekteve dhe pajisjeve joadekuate, mungesës së fuqisë punëtore, prodhimit të paligjshëm, mungesës së njohurive dhe nevojës për trajnime. Nevojitet menaxhim efikas në shfrytëzimin e burimeve ekzistuese natyrore, marketing dhe promovim adekuat. Burimet e jashtëzakonshme natyrore dhe një mori zonash bujqësore të papërdorura dhe të pandotura paraqesin një burim të madh për përmirësimin e prodhimit dhe cilësisë, zhvillimin e prodhimit organik. Në rrugën drejt integritimit evropian dhe kritereve më

të rrepta në lidhje me sigurinë ushqimore, prodhuesit do të përballen me një nevojë në rritje për të harmonizuar procesin e prodhimit me standardet e kërkuara.

Spektori i bujqësisë përballlet me mungesë të të dhënave bujqësore në nivel lokal për prodhimin bujqësor dhe potencialin familjar, gjë që paraqet një problem serioz në monitorimin e cilësisë së produktit. Kapacitetet e regjistruara përpunuese tregojnë një tendencë rritjeje dhe diversifikimi gjatë viteve të fundit, duke përmirësuar kushtet e përpunimit duke investuar në teknologji të reja dhe duke futur standarde të cilësisë. Shkalla e shfrytëzimit të kapaciteteve ekzistuese përpunuese është rreth 50%, që është shumë e ulët.

Investimi në bujqësi është shumë i vështirë për t'u siguruar duke pasur parasysh kushtet e këqija të kreditimit, vlerën e ulët të tokës dhe pasurive të paluajtshme bujqësore në treg dhe mosbesimin e bankave ndaj fermerëve kur bëhet fjalë për investimet në bujqësi.

Në fushën e harmonizimit me standardet e Bashkimit Evropian, po bëhen përpjekje të mëdha në sektor dhe rregullimet ligjore vazhdojnë trendin e harmonizimit me rregulloret e BE-së. Në një masë të madhe, tashmë ka përaftrim, por zbatimi i vazhdueshëm i tij në praktikë dhe as përaftrimi i politikave vendore me të, nuk është vënë re.

Shoqata e prodhuesve nuk është në një nivel të kënaqshëm dhe me mbështetjen e shtetit në këtë drejtim, modeli i kooperativave evropiane apo mënyra të ngjashme shoqërimi, me përdorimin adekuat të fondeve të disponueshme apo të ardhshme të BE-së, mund të jetë shtytësi i zhvillimit dhe kthesës në sektor.

5. PRODHIMTARIA TRADICIONALE DHE ORGANIKE

5.1 Produkte tradicionale, gjeografikisht të njohura dhe cilësore

Strategjia për Zhvillimin e Bujqësisë dhe të Zonave Rurale të Malit të Zi 2014-2020 njihet rëndësinë e përmirësimit të produkteve të bazuara në cilësi. Një nga shanset për zhvillimin e bujqësisë së Ulqinit, si në tregun vendor ashtu edhe në atë rajonal, është që sa më shumë produkteve t'i përmirësohet dhe ruhet cilësia, përmes menaxhimit dhe kontrollit, por edhe duke ngritur cilësinë, në mënyrë që produktet të vlerësohen në treg.

Cilësia e produkteve me origjinë gjeografike dhe tipare tradicionale është e rrënjësuar në burimet lokale dhe është e lidhur ngushtë me to, ndaj mbijetesa dhe përmirësimi i sistemit të prodhimit shpesh luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e ekonomisë dhe stilit të jetesës. Shtimi i vlerës së një produkti të tillë, duke mbrojtur njëkohësisht tiparet kryesore të tij, mundëson leverdinë dhe rinovimin e burimeve lokale, duke kontribuar kështu jo vetëm në sistemin e prodhimit, por edhe në zhvillimin e fshatrave, komuniteteve lokale dhe, gjithnjë e më shumë, burimeve të ndjeshme natyrore. Kjo do të thotë gjithashtu arritje të sinergjisë me dy shtyllat e tjera bazë të zhvillimit të qëndrueshëm: mjedisin dhe shoqërinë.

Baza e politikës së cilësisë, si pjesë e politikës së zhvillimit bujqësor dhe rural, është ngritja e një sistemi për mbrojtjen e produkteve bujqësore dhe ushqimeve me markë të origjinës dhe atë gjeografike, si dhe një sistem për mbrojtjen e produkteve me veti dhe karakteristika të veçanta, që rrjedhin nga metodat tradicionale të prodhimit dhe përgatitjes, si dhe markën: "cilësi e lartë";

"produkt mali" dhe "nga ferma ime". Produktet që veçohen për nga mënyra e prodhimit ose përpunimit, si dhe zona e origjinës, e që si rrjedhojë ndryshojnë nga produktet e së njëjtës kategori, mund të regjistrohen me markat e përmendura.

Ligji për Skemat e Cilësisë (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi, nr. 22/2017) parasheh mënyrën dhe procedurën për përcaktimin e të gjitha skemave të cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore, si dhe vlerësimin e përputhshmërisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore me specifikimet e këtyre produkteve. Barrierat aktuale lidhen kryesisht me mungesën e njohurive (niveli i ulët i ndërgjegjësimit të prodhuesve dhe konsumatorëve), koordinimit dhe motivimit për të zbatuar detyrimet dhe praktikatat e mira, mungesa e kapaciteteve administrative në shërbimet lokale dhe këshillimet për këshillimet në këtë fushë, mungesa e kontrolleve si nga organet certifikuese ashtu dhe nga inspektoratet shtetërore, ndaj me gjithë procedurat e vendosura institucionale, në treg nuk ka produkte të regjistruara në ndonjë nga skemat vullnetare të cilësisë.

Në nivel shtetëror deri më tani janë regjistruar nëntë produkte, përkatësisht: "*Njeguški pršut*" (në shqip "Proshuta e Njegushit") - marka gjeografike, "*Pljevaljski sir*" (në shqip "Djathi i Plevlave") – marka e origjinës, "*Crnogorska goveda pršuta*" (në shqip "Proshutë lope e Malit të Zi") – marka e origjinës, "*Crnogorska stelja*" (në shqip "Mish i thatë i Malit të Zi") – marka e origjinës, "*Crnogorski pršut*" (në shqip "Proshutë e Malit të Zi") - markë gjeografike, "*Durmitorski Skorup*" (në shqip "Kajmak i Durmitorit") – markë e origjinës, "*Kolašinski lisnati sir*" (në shqip "Djath i Kollashinit me fleta") – markë e origjinës, birrë gruri "*Čista desetka*" – marka cilësi e lartë, "*Bamija na ulcinjski način*" (në shqip "Bamje në mënyrën e Ulqinit"), markë e specialitetit tradicional të garantuar.

Produkti i PARË i mbrojtur si specialitet tradicional i garantuar (STG) e ka origjinën pikërisht nga Ulqini dhe është "Bamja në mënyrën e Ulqinit". Iniciator dhe bartës i këtij emri të mbrojtur është shoqata joqeveritare Shoqata për Kultivimin dhe Promovimin e Bamjes nga Ulqini. Bamja e përgatitur në mënyrë tipike, karakteristike për Ulqinin, ofrohet si specialitet gastronomik prej dekadash. Dëshmi e këtij pretendimi është menyuja nga "Kulla e Balshajve" dhe "Pallati Venecia" nga viti 1996. Këtë vit dy hotelet e përmendura nga Ulqini organizuan edhe një prezantim përmes degustimit të bamjeve të përgatitura në Hotel "Crna Gora".

Efektet juridike të regjistrimit të emrit STG nuk lidhen drejtpërdrejt me konceptin e territorit, siç janë markat gjeografike, dhe të gjithë prodhuesit që prodhojnë sipas specifikimit kanë të drejtë të përdorin emrin e regjistruar, pavarësisht se ku ndodhen, respektivisht ku kryhet prodhimi, nëse plotësojnë rregulloret e miratuara për produktet (ushqimore) që janë rezultat i procesit të prodhimit, që korrespondon me mënyrën tradicionale të përgatitjes dhe përpunimit të atyre produkteve ose produktet prodhohen duke përdorur lëndë të para ose përbërës. që përdoren tradicionalisht në prodhim. Emri i mbrojtur i specialitetit tradicional të garantuar ose marka (logoja) e përshkruar kombëtare nuk mund të përdoret më në deklaratën e produkteve të ngjashme bujqësore ose ushqimore që nuk plotësojnë kërkesat e specifikimeve të publikuara të specialitetit tradicional të garantuar.

STG është një skemë shumë specifike, pasi mund të mbulojë një numër të madh përdoruesish. Gjegjësisht, marka STG mund të përdoret për produkte me karakteristika të veçanta që rrjedhin nga përdorimi i përbërësve tradicionalë ose nga metoda tradicionale e përgatitjes. "Tradicional"

nënkupton përdorimin e provuar të produktit në treg gjatë një periudhe kohore që tregon përcjelljen nga brezi në brez, që zgjat të paktën 30 vjet.

Ulqini ka një potencial jashtëzakonisht të lartë për zhvillimin e skemave cilësore të bazuara në një traditë të gjatë dhe një reputacion të lartë dhjetëvjeçar, gjë që vërtetohet nga disa burime letrare. Disa prej tyre janë:

- **“Thesari gastronomik i Ulqinit”** – OJQ MogUl, i botuar në vitin 2019, i përkrahur dhe i pranuar në nivel lokal dhe shtetëror. Është kontribut për ruajtjen e pasurisë gastronomike dhe autenticitetit të kuzhinës ulqinake, e cila ka një traditë të gjatë. Publikimi është rezultat i viteve të kërkimit mbi trashëgiminë gastronomike dhe metodat e prodhimit;
- **“Kalendari i gjyshes sime”** (botuar në librin “Thesaret gastronomike të Ulqinit”) – autori udhëhiqet nga jeta e gjyshes dhe “*qakulimet*” e saja me nusen për gjënë më të rëndësishme në botë – ushqimin. Viti filloi në mars, me shfaqjen e kublës dhe përfundoi me rosat dhe patat e egra, të ngrira në basenet e Kripores. Recetat tradicionale nga Ulqini janë të shënuara në botimin e përmendur;
- **“Kuzhina tradicionale e gjyshes”**, motrat Adaleta dhe Xhenana Bibeziq botuan në vitin 2016 librin si monument i qytetit, kulturës dhe kohës. Koha kur u krijuan gatimet ulqinake ka kaluar, por duhet kujtuar se krijimi i tyre zgjati me shekuj. Libri tradicional i kuzhinës është një vepër pioniere, e cila ka më shumë se 130 receta autentike, shumica e të cilave të shkruara për herë të parë për arsyen e, siç theksojnë motrat Bibeziq, dembelinë e banorëve të kësaj zone kur duhet shkruar diçka;
- Libri i gatimit **“Shijet e Malit të Zi 2”** - Receta dhe pjata nga oferta e pasur gastronomike janë mbledhur nga Shoqata e Kuzhinierëve të Malit të Zi. Botimi përmban receta për 150 pjata - gatime të pranishme, tradicionale, në territorin e Malit të Zi - nga bregdeti në veri, ndër të cilat ka shumë gatime tradicionale ulqinake.

Për të pasur një pasqyrë të trashëgimisë së pasur gastronomike të Ulqinit, e cila është një bazë e mirë për mbrojtjen e specialiteteve tradicionale, do të përmendim produktet bujqësore/gatimet/specialitetet gastronomike të përfshira në "Kalendarin e gjyshes sime" të botimit “Thesari gastronomik i Ulqinit” – OJQ MogUl në tabelen 14:

Tabela 14: Produkte/gatimet tradicionale në territorin e Ulqinit

Produktet/Ushqimet tradicionale në territorin e Ulqinit		
Gjel me hudhër e uthull	Groshë (Fasule)	Bakllavë
Supë me eshna (kocka)	Rashtan (lakër kale)	Hurmashica
Supë me mish të thatë	Petulla me spinaq e kos	Hallvë e bardhë
Çorbë mishi (goste)	Patate me qumësht	Hallvë e kuqe
Çorbë peshku	Pite	Zerde
Mish kapama	Pite me kos	Haxhimakule
Mish kafërma	Pite me erëza	Aksude

Mish me kos e vezë	Pite me mëlçi	Pelte
Tavë mishi me salcë	Pite me patate	Tespixhe
Mish qengji me kos e hudhër	Pite me kungull (pite lakuriqe)	Ashure
Mish me erëza	Pite me presh	Gurabija
Tirit	Lakror	Ravani
Kim me vezë	Pite me jeshilin	Rollaç
Mish me patate	Byrek me djathë (gjizë)	Kadaif
Mish dashi në furrë	Filxhan byrek	Furdulluq
Fërlík	Grurë	Kastanjik
Pllanca (përbrendësa)	Përpeq	Tollumba
Qofte kapama	Paçamur me bukë kallamoqi	Rolatë me grizë
Petë me gjel ose rosë	Bukë kallamoqe (qethi)	Komposto (Hashaf)
Peshk kapama	Terhan	Sherbet për Mevlud
Ngjala me oriz	Terhan i kuq	Ullinj të gjelbër
Krap me salcë (iç në tavë)	Qull	Ullinj të zinj
Peshk me oriz	Tejtur	Pastë nga ullinj të
Qefull i fërguar	Tarator	Tëlyen
Kubla në tavë	Kryelanë	Salcë domatesh (nerden)
Tavë me speca të mbushur	Paçamur	Jufkë shtëpie (arishte)
Bishtajë	Bukë shtëpie	Djathë shtëpie
Bamje	Bukë kallamboqi	Kos shtëpie
Musakë	Djathë i fërguar	Uthull nga mollët e egra
Spinaq me oriz	Petulla me kos	Uthull vere
Patëllxhan kokërr (patlixhana)	Kamkuqe	Reçel ftoni
Patëllxhan me djathë	Llokume	Pekmez fiku
Patëllxhan me vezë	Petulla lugë-lugë	Pekmez mani
Japarak	Simitet	Reçel me fiq të egër
Patëllxhan me kos	Syti princ (oriz me tamël)	Fiq të thatë
Dolmë me mish	Sarajli	Lëng thane
Qofte me kos	Luleshegë	Lëngë nga lulja e majit (trëndafili)
Sallatë kapama		Shurup nga shega e egër

Në kuadër të aktiviteteve të projektit Foodnected, Shoqata MSJA – Dr. _ Martin Schneider - Jacoby ka realizuar pyetësorët me gjithsej 19 palë të interesuara lokale, të cilët po ashtu ishin pjesë e punëtorisë dyditore. Pyetësorët ishin të dedikuarë për profile të ndryshme: prodhues të perimeve dhe frutave, restorante, peshkatarë. Bazuar në rezultatet e pyetësorit, por edhe në komunikim të drejtpërdrejtë me palët e interesuara lokale gjatë punëtorisë dyditore, u konkludua se kjo zonë ka një potencial të madh kur bëhet fjalë për produktet tradicionale, recetat dhe varietetet autoktone. Produktet/gatimet e përzgjedhura përputhen me listën më të gjerë të produkteve më poshtë, por patjetër do të veçonim disa, të cilat u identifikuan nga pjesëmarrësit, konkretisht: bamjet e Ulqinit, e cila tashmë ka marrë markën e një specialiteti tradicional të garantuar në nivel nacional, japarakun, gurabijet, për të cilët është lidhur tradita, ullinj të zi dhe jeshil (lloji vajuk), nga të cilët përveç vajit, bëhet edhe pasta, pastaj gjalpë shtëpie nga qumështi i lopës dhe lëngu nga trëndafili i majit dhe shega e egër.

Kur flasim për produkte bujqësore që kanë një potencial të madh për mbrojtjen e treguesit gjeografik, sepse janë lloje autoktone dhe specifike, dhe kanë një traditë të gjatë prodhimi, janë ulla, vaji i ullirit, shega, fiku, mandarina, shalqiri i Ulqinit, etj.

Duke pasur parasysh se një nga kërkesat për regjistrimin e skemave të cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore është një traditë e dëshmuar, trashëgimia letrare është e një rëndësie të jashtëzakonshme.

Cilësia, origjina, specifika dhe autenticiteti janë përcaktues të rëndësishëm, janë pika të forta dhe të rëndësishme të bujqësisë vendase, sepse ofrojnë avantazh konkurrues dhe mbijetesë për prodhuesit e vegjël, specifike dhe tradicionale dhe japin një kontribut të madh në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe gastronomike. Mbrojtja e skemave cilësore është pasojë e aftësive dhe vendosmërisë së prodhuesve, të cilët ruajtën traditën, por gjithashtu morën parasysh zhvillimin e përbërësve dhe metodave të reja të prodhimit, modernizimin e prodhimit dhe produkteve, si dhe valorizimin përmes sektorit të turizmit. Me mbrojtjen e produkteve të tilla arrihet njohja në treg, si në nivel lokal ashtu edhe në atë rajonal dhe ndërkombëtar, dhe në këtë mënyrë produkti kontribuon në njohjen e vendit dhe rajonit. Promovimi dhe mbrojtja e produkteve me marka cilësore kontribuojnë në zhvillimin rural, diversifikimin e produkteve ushqimore dhe zgjedhjen më të madhe të konsumatorëve. Mbrojtja e produkteve cilësore, tradicionale dhe specifike kontribuon për një ofertë më të pasur turistike dhe për zhvillimin e vetë destinacioneve turistike.

Ka shumë arsye pse prodhuesit ulqinakë duhet t'i shtojnë vlerën produkteve të tyre. Disa nga kryesoret janë:

(1) Kërkesa për këto produkte është rritur sepse kërkesat e konsumatorëve po ndryshojnë në drejtim të zhdukjes së konsumatorit mesatar që ka blerë produktin me çmim mesatar, dhe konsumatorët po diferencohen gjithnjë e më shumë në ata që blejnë më lirë ose më shtrenjtë;

(2) Konkurrueshmëria dhe fitimi rriten me prodhimin e këtyre produkteve, megjithëse, si rregull, kostot e prodhimit dhe shitjes së produkteve me vlerë të shtuar janë më të larta - por çmimi më i lartë i shitjes kompenson rritjen e kostove;

(3) ofrohen mundësi të reja shitjeje, pasi produktet me vlerë të shtuar mundësojnë pika të reja shitjeje që janë të paarrtshme për produktet e zakonshme (nëse nuk keni një standard, nuk mund të shitni në një zinxhir të caktuar supermarketesh, nëse keni një markë gjeografike, ju mund të pozicionojë produktin në një vend të caktuar);

(4) Është më e lehtë për të marrë mbështetje (veçanërisht nga CPA e BE-së, për të cilën Mali i Zi aspiron dhe do të bëhet anëtar), sepse mallrat e burës i lihen gjithnjë e më shumë tregut, kurse theksi në subvencionimin i kushtohet produkteve me vlera të shtuara, veçanërisht kur ato kanë të bëjnë me të mirat publike (mbrojtjen e mjedisit, mirëqenien sociale, kulturën...);

(5) Arritja e sinergjisë me aktivitetet e tjera dhe arritja e një efekti të rëndësishëm ekonomik nëpërmjet një oferte sinergjike. Si rregull, për produktet me vlerë të shtuar ka mundësi më të madhe të lidhjes me shërbimet, arkitekturën popullore, traditën;

(6) këta prodhues janë më të respektuar dhe më të pranuar.

Përveç orientimit cilësor, ka mënyra të tjera për t'i shtuar vlerën produkteve me shumicë. Më të rëndësishmet janë:

(1) futja e standardeve - meqenëse blerësi është larguar nga prodhuesi, ai nuk e njeh më atë, kështu që ai kërkon një garanci se produkti ka një vlerë për të cilën ai është i gatshëm të paguajë më shumë;

(2) marka e origjinës gjeografike, me të cilat ne konfirmojmë se specifika e produktit është krijuar në një kombinim unik të burimeve natyrore lokale (klime, toka, varietetet e kafshëve ose bimëve) dhe traditave, njohurive dhe aftësive që janë përcjellë nëpër breza, të gjitha në një territor të caktuar;

(3) përgatitja e produktit për shitje, e cila përfshin një shumëllojshmëri të gjerë aktivitetesh, nga paketimi deri te komunikimi prodhues-konsumator, që përfshin historinë që shoqëron produktin, reklamimin, markimin, pozicionimin, promovimin, publicitetin dhe teknika të tjera;

(4) promovimi i shitjeve, pasi produktet me vlerë të shtuar kërkojnë marketing të ndryshëm - mënyra dhe vende të ndryshme shitjeje (duke mos përjashtuar shitjet e drejtpërdrejta, që po rriten si metodë e shitjes së produkteve me vlerë të shtuar).

5.2 Prodhimi organik

Prodhimi organik është një nga prioritetet për zhvillimin e bujqësisë malazeze dhe zë një vend të rëndësishëm në Strategjinë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Zonave Rurale të Malit të Zi 2014-2020. Interesi për prodhimin organik në Mal të Zi ka qenë veçanërisht i fortë që nga viti 2015. Në sektorin e pemëtarisë, krahasuar me periudhën deri në vitin 2015, ka një rritje të ndjeshme të frutave dhe produkteve të frutave të certifikuara organikisht. Një nga metodat më efektive që ndikojë në rritjen e numrit të prodhuesve dhe vëllimit të prodhimit organik janë masat mbështetëse, masat kombëtare dhe IPARD. Fusha e prodhimit organik rregullohet me Ligjin për Prodhimtarinë Organike ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 56/13).

Regjistri i subjekteve në prodhimin organik menaxhohet nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës. Janë 445 prodhues të regjistruar dhe 169 të certifikuar (të dhënat nga viti 2021). Në vitin 2021, numri i prodhuesve të regjistruar u rrit me 7.5%. Numri më i madh i prodhuesve organikë gjendet në pjesën veriore (92%), ndërsa 8% është në pjesën qendrore dhe jugore të Malit të Zi.

Sipërfaqja e përgjithshme e punueshme që është në proces certifikimi arrin në 863.35 ha. Nga kjo, 606,55 ha janë me statusin e prodhimit organik, dhe 256,8 ha janë në periudhën e tranzicionit, që do të thotë se 70,25% e prodhimit në tokë është me statusin organik. Pjesa më e madhe e sipërfaqeve me prodhim frutash është 65,24%, e ndjekur nga sipërfaqet me prodhim bimor me 34,31%, ndërsa sipërfaqet me prodhim perimesh përfaqësohen me 0,44% në raport me sipërfaqet totale të punueshme (863,35 ha) që janë në proces certifikimi. Sipërfaqja prej 3563.98 ha është nën livadhe dhe kullota, të cilat përdoren më së shumti për kositjen dhe kullotjen e bagëtive.

Tabela 15: Prodhimi organik 2016–2021

Zona e prodhimit	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Kulturat shumëvjeçare (ha)	412	426	456	508	564	563
Tokë e punueshme (ha)	272	262	309	321	307	300
Livadhe dhe kullota (ha)	2680	2032	3696	3925	3952	3,5634
Blegtoria (koka)	-	-	403	39	393	439
Rritja e deleve (koka)	1,428	863	1092	1309	1,369	938
bletaria (koshere)	506	839	1,103	1964	3381	1980
shpendë (pula)	267	390	170	160	300	200

Burimi: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, 2021

Mbështetja për prodhuesit organikë ofrohet aktualisht vetëm përmes fondeve kombëtare. Masat e përcaktuara janë: 1. Mbështetja e prodhimit organik dhe 2. Mbështetja për tregtimin e produkteve organike. Mbështetja për prodhimin organik realizohet në formën e pagesave direkte, për hektar në prodhimin bimor dhe për krerë të kushtëzuar bagëti, shpendë dhe koshere, në prodhimtari blegtorale. Me akreditimin e Masës 4 të programit IPARD III, këto aktivitete do të financohen nga fondet e BE-së. Mbështetja për tregtimin e produkteve organike është një masë përfituese të së cilës janë prodhuesit organikë të regjistruar në Regjistrin e Subjekteve të Prodhimit Organik, i cili administrohet nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, ekskluzivisht për produktet për të cilat ata kanë certifikatë nga një organi i akredituar dhe i autorizuar për kontrollin e prodhimit organik dhe që vendos në treg produktet organike.

Prodhimi organik ka një rëndësi të madhe për zhvillimin e zonave rurale, sepse jep një shans për zhvillimin e fermave bujqësore dhe prodhuesve të vegjël, kontribuon në rritjen e të ardhurave të fermave, si dhe në valorizimin përmes sektorit të turizmit.

Komuna e Ulqinit nuk ka prodhues organikë të regjistruar, përkundër potencialit të jashtëzakonshëm dhe mbështetjes së mirë shtetërore, që është rezultat i drejtpërdrejtë i lidhjes së dobët horizontale dhe vertikale të aktorëve vendorë dhe shtetërorë, zhvillimit të ulët të vetëdijes dhe njohurive të ulëta si të pjesëmarrësve ashtu edhe të prodhuesve vendorë.

6. KUADRI INSTITUCIONAL QË NDIKON DREJTPËRDREJT NË ZHVILLIMIN E SEKTORIT

Vetëqeverisja lokale e Komunës së Ulqinit është përgjegjëse për zhvillimin e bujqësisë, përcaktimin e strategjive, programeve, masave mbështetëse, qëllimeve dhe vizionit, si dhe monitorimin dhe menaxhimin e drejtimeve zhvillimore në nivel lokal.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU) si institucion ombrellë propozon ligje dhe rregullore të tjera ligjore, zgjidhje sistimore në bujqësi, përcakton politikën agrare dhe ndërmerri masa për zbatimin e saj. Gjithashtu, i propozon Qeverisë masa nxitëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural me Rregulloren për kushtet, mënyrën dhe dinamikën e zbatimit

të masave të politikës bujqësore (në tekstin e mëtejshëm: Agrobuxheti) dhe një sërë dokumentesh, rregulloresh dhe aktesh të tjera të nevojshme për të koordinuar funksionimin dhe zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave në kuadër të organizimit ofron konsulencë nëpërmjet dy strukturave organizative: Drejtorisë së Shërbimeve Këshillimore në Prodhimin Bimor dhe Drejtorisë së Shërbimeve Këshillimore në Blegtori. Dy drejtoritë e përmendura janë të karakterit rajonal, dhe konsulenca më e afërt me Komunën e Ulqinit është zyra rajonale në Tivar, e cila ka të punësuar dy zyrtarë.

Laboratorët, testimi i cilësisë dhe sigurisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore kryhen nga laboratorë të specializuar: Laboratori Veterinar Special, Instituti i Shëndetit Publik, Qendra e Testimeve Ekotoksikologjike (CETI), Laboratori Fitosanitar, Laboratori për Qumështari dhe Laboratori për Studimet e Tokës dhe Bonifikimin.

Administrata për Sigurinë Ushqimore, Veterinarinë dhe Çështjet Fitosanitare, shërbim i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që kryen regjistrimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e objekteve të trajtimit, përpunimit, përgatitjes, servirjes, shpërndarjes, hotelerisë dhe tregtisë së ushqimeve.

Institucionet kërkimore dhe arsimore dhe asistencë profesionale:

Fakulteti Bioteknik është njësi e Universitetit të Malit të Zi që ka funksion arsimor, shkencor dhe këshillues në fushën e bujqësisë dhe pylltarisë. Rolin e tij edukativ (mësimdhënës) e kryen që nga viti 2005/2006. vjet. Në kuadër të fakultetit zhvillohen dy programe studimi: Blegtoria dhe Prodhimtaria Bimore. Studimet pasuniversitare, të specializuara dhe master, në fushën e prodhimit bimor përfshijnë tre programe, përkatësisht: Pemëtaria dhe vreshtaria; Bujqësia e kulturave dhe perimeve dhe Mbrojtja e bimëve, kurse studimet pasuniversitare specialistike dhe master në fushën e blegtorisë organizohen si një program i vetëm studimi - Blegtori. Fakulteti Bioteknik zotëron një fushë eksperimentale në lokacionin *Lješkopolje*, me 25 ha vreshta, pemishte, serra dhe një bodrum vere me kapacitet 300 hl. Që nga themelimi i tij, Fakulteti i Bioteknologjisë ka kontribuar në zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen bujqit duke aplikuar shërbime moderne kërkimore, arsimore dhe të tjera. Fakulteti ka krijuar bashkëpunim me sektorin ekonomik përmes një numri të madh të marrëveshjeve të lidhura dhe aktiviteteve të realizuara, si dhe janë aktivë edhe në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore, Sigurisë Ushqimore dhe Ekologjisë (në tekstin e mëtejshëm: FTUSUE) është themeluar në vitin 2012, në kuadër të *Universitetit Donja Gorica*. Aktivitetet kryesore të fakultetit janë të natyrës arsimore, shkencore dhe kërkimore. FTUSUE ka katër degë (inxhinieri teknologjike, inxhinieri sanitare, inxhinieri mjedisore dhe inxhinieri e sistemit HoReKa) brenda studimeve universitare. Si institucion kërkimor shkencor, FTUSUE mbulon fushat e mëposhtme: kërkimin bazë, kërkimin e aplikuar, ofrimin e shërbimeve, promovimin, rrjetëzimin dhe bashkëpunimin. Lidhja me ekonominë pasqyrohet në aktivitetet e mëposhtme: organizimi i praktikës dhe ushtrimeve profesionale për studentët, puna në laborator dhe puna në projekte. FTUSUE ka krijuar bashkëpunim të mirë me kompani të shumta në fushën e bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit, si dhe me universitete, fakultete dhe institucione kërkimore nacionale dhe ndërkombëtare.

Në territorin e Malit të Zi janë të organizuara pesë shkolla të mesme profesionale. Në kuadër të programit të punës së tyre është paraparë edhe edukimi i profileve në fushën e bujqësisë, përpunimit të produkteve bujqësore dhe veterinarisë. Në këto shkolla trajnohen pjesërisht kuadrot e profileve të teknikëve bujqësorë të orientimeve të ndryshme (bujq, pemëtar, vreshtar, perimtar, blegtor, veteriner, qumështor, duhanprodhues, kasap, bukëpjekës etj.).

Institucione dhe organizata të tjera

Zhvillimin e bujqësisë kontribuojnë edhe Qendra për Arsim Profesional, Organizatat Lokale të Turizmit, Organizatat Joqeveritare, Enti për Punësim i Malit të Zi, Drejtoria për Zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, Fondi i Investimeve dhe Zhvillimit, bankat komerciale, e të tjera, por në një masë shumë më të vogël. Ata, në përputhje me kompetencat e tyre, kryejnë veprimtari që mbështesin zhvillimin e bujqësisë përmes promovimit, veprimit publik, miratimit të mbështetjes kreditore për bujqit, të papunët dhe/ose ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në fushën e bujqësisë dhe agroindustrisë, dhe duke organizuar trajnime. Dhoma e Tregtisë e Malit të Zi dhe Unioni i Punëdhënësve ofrojnë mbështetje të konsiderueshme për zhvillimin e bujqësisë në Mal të Zi, përmes aktiviteteve që ata kryejnë.

7. MASAT MBËSHTETJE NË NIVEL SHTETËROR

AGROBUXHETI

Mbështetja financiare nacionale për sektorin e bujqësisë përcaktohet me Ligjin për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, Ligjin për Buxhetin për vitin aktual dhe Rregulloren për kushtet, mënyrën dhe dinamikën e zbatimit të masave të politikës bujqësore - agrobuxhetin, i cili miratohet çdo vit.

Rregullorja e lartpërmendur përcakton kushtet, mënyrën dhe dinamikën e zbatimit të masave të politikës bujqësore për politikën e çmimeve të tregut, politikën e zhvillimit rural, çështjet e interesit publik, transfertat sociale për individët, masat në fushën e sigurisë ushqimore, çështjet veterinarë dhe fitosanitare, dhe masat në fushën e peshkimit.

Me Rregulloren për kushtet, mënyrën dhe dinamikën e zbatimit të masave të politikës bujqësore për vitin 2022 - agrobuxhetin për vitin 2022 parasheh mjete në vlerë të përgjithshme prej 50,877,757,51 €, përkatësisht: organit të administratës shtetërore përgjegjës për bujqësi, pylltari dhe ekonominë e ujërave dhe organit të administratës përgjegjës për çështjet e sigurisë ushqimore, veterinarë dhe fitosanitare në buxhetin e Malit të Zi për vitin 2022. (në tekstin e mëtejshëm: buxheti) në vlerë të përgjithshme 35,905,287,45 €, nga donacionet në vlerë 8,200,470,06 € dhe nga kreditë në vlerë 6,772,000,00 €.

Mjetet e parapara në buxhet në vlerë të përgjithshme prej 35,905,287,45€ i referohen:

- 1) zhvillimit të bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit 31,675,158,20 €;
- 2) kontributi për realizimin e projekteve ndërkombëtare (IFAD) 1,726,000,00 €;
- 3) zbatimi i masave për sigurinë e ushqimit dhe ushqimit të kafshëve 286,557,69€;
- 4) zbatimi i masave për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve 2,038,513,44€;
- 5) zbatimi i masave fitosanitare 179,058,12€.

Struktura e buxhetit bujqësor në vitin 2022

Buxheti i bujqësisë është i ndarë në pesë pjesë, përkatësisht: masat e politikës së çmimeve të tregut; masat e zhvillimit rural; mbështetje për shërbimet dhe shërbimet e përgjithshme në bujqësi; peshkimi dhe të tjerët.

1. Masat e politikës së çmimeve të tregut përfshijnë: pagesat direkte dhe masat e stabilizimit të tregut.

Pagesat direkte përfshijnë masat e mëposhtme:

- pagesat direkte në prodhimtarinë blegtorale;
- mbështetje për përpunimin e qumështit në fermë;
- pagesat direkte në prodhimin bimor;
- mbështetje për prodhimin e materialit farë;
- pagesat direkte për prodhimin e duhanit;
- programi për përmirësimin e bletarisë.

Masat për stabilizimin e tregut përfshijnë: programin e investimeve të tregut dhe menaxhimin e riskut në bujqësi.

2. Masat e zhvillimit rural ndahen në tre boshte:

- masat për të forcuar konkurrencën e prodhuesve të ushqimit,
- masat për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore,
- masat për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe zgjerimin e aktiviteteve ekonomike në zonat rurale.

Masat për forcimin e konkurrencës së prodhuesve të ushqimit përfshijnë: MIDAS 2 - komponenti 1, Forcimi i programit të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit; Programi IPARD II – program për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale në kuadër të IPARD 2014–2020; mbështetje për zhvillimin e vreshtarisë dhe verëtarisë; mbështetje për ndërtimin dhe modernizimin/pajisjen e pemishteve, mbështetje për zhvillimin e ullishtarisë; mbështetje për prodhimin e perimeve; mbështetje për rritjen e plantacioneve shumëvjeçare të bimëve mjekësore dhe aromatike; mbështetje për ngritjen dhe mirëmbajtjen e plantacioneve amë të llojeve të caktuara të frutave dhe pyjeve; mbështetje për arritjen e standardeve të mirëqenies së kafshëve në blegtori; mbështetje për përmirësimin e cilësisë së qumështit të papërpunuar; mbështetje për aktivitetet e kooperativave, shoqatave dhe organizatave të prodhuesve; mbështetje për blerjen e bagëtive të racës së pastër; mbështetje për blerjen e makinerive, lidhjeve dhe pajisjeve në funksion të prodhimit primar; mbështetje për investime për ndërtimin e puseve dhe cisternave; mbështetje për fillimin dhe zhvillimin e bizneseve të bujqve të rinj; mbështetje për forcimin e rrjetit të blerjes së qumështit; mbështetje për zhvillimin e klasterave në fushën e bujqësisë; mbështetje për investime në përpunim në ferma; mbështetje për sipërmarrjen e femrave në bujqësi; mbështetje për futjen e inovacioneve në sektorin e bujqësisë.

Masat për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore përfshijnë: ruajtjen e burimeve gjenetike autoktone në bujqësi; mbështetje për prodhimin organik; përdorimi i qëndrueshëm i kullotave malore; mbështetje për menaxhimin e plehut organik.

Masat për përmirësimin e jetës dhe zgjerimin e aktiviteteve ekonomike në zonat rurale përfshijnë: mbështetje për investime në përshtatjen e kasolleve malore; zhvillimin e fshatit dhe ndërtimin e infrastrukturës.

3. Mbështetje për shërbimet dhe serviset e përgjithshme në bujqësi

Mbështetja për shërbimet dhe serviset e përgjithshme në bujqësi përfshin arsimin, kërkimin, zhvillimin dhe analizën; programin për përmirësimin e blegtorisë; programin e masave të kontrollit të cilësisë së produktit; mbështetje për cilësinë e produktit - skemat e cilësisë; mbështetje për tregtimin e produkteve organike; futja e standardeve të cilësisë dhe sigurisë ushqimore; promovimi i produkteve bujqësore dhe bujqësisë, edukimi dhe udhëtimet studimore të prodhuesve bujqësorë; mbështetje teknike dhe administrative për zbatimin e programit.

4. Transferta sociale për popullsinë rurale përfshijnë: programin e përfitimeve të pleqërisë.

5. Peshkimi - masat në këtë sektor përfshijnë: modernizimin e flotës profesionale të peshkimit për zënie të resurseve demerale; modernizimi i flotës profesionale të peshkimit për kapjen e resurseve pelagjike; modernizimi i flotës profesionale të peshkimit në peshkimin e vogël tregtar; përmirësimi i konkurrencës dhe efikasitetit të sektorit të marikulturës; pagesat direkte në marikulturë - kultivimin e guacave; menaxhimin e qëndrueshëm dhe ruajtjen e burimeve të peshkut dhe organizmave të tjerë detarë; menaxhimi i sistemit të monitorimit dhe kontrollit të peshkimit (RMC); MIDAS 2 – komponenti 3, modernizimi i sektorit të peshkimit; menaxhimi i qëndrueshëm i peshkimit në ujërat e ëmbla; përmirësimi i peshkimit komercial në liqenin e Shkodrës; përmirësimi i konkurrencës dhe efikasitetit të sektorit të akuakulturës së ujërave të ëmbla; pagesat direkte në akuakulturë.

Përveç masave të mësipërme, buxheti i bujqësisë përfshin si më poshtë:

PROGRAMI I MASAVE TË SIGURISË SË USHQIMIT DHE TË KAFSHËVE: Krijimi dhe funksionimi i një sistemi efektiv për zbulimin e rreziqeve në ushqim dhe ushqimin e kafshëve, reduktimin e shfaqjes së sëmundjeve të shkaktuara nga ushqimi, sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njeriut, rritjen e prodhimit dhe sigurimin e tregtisë së qetë të ushqimit dhe ushqimit të kafshëve. Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative për zbatimin e standardeve të BE-së në këtë fushë. Procesi i negociatave me Komisionin Evropian dhe zbatimi i reformave kërkon bashkëpunim me gamë më të gjerë të palëve të interesuara: subjektet në biznesin ushqimor, shoqatat e prodhuesve bujqësorë, sektori civil, vetëqeverisjet lokale, mediat;

PROGRAMI I MASAVE TË DETYRUARA TË MBROJTJES SË SHËNDETIT TË KAFSHËVE: Krijimi dhe funksionimi i një sistemi efikas të kujdesit shëndetësor dhe kontrollit të shëndetit të kafshëve, si dhe marrja e statusit të një vendi të pastër nga disa sëmundje infektive

si parakusht për tregtinë e papenguar të kafshëve dhe produkteve me origjinë shtazore. . Forcimi i mbështetjes institucionale për zbatimin më të shpejtë të standardeve të BE-së në fushën e shëndetit të kafshëve dhe identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve. Procesi i negociatave me Komisionin Evropian dhe zbatimi i reformave kërkon bashkëpunim me gamën më të gjerë të palëve të interesuara: kafshët, shoqatat e prodhuesve bujqësorë, sektorin civil, vetëqeverisjet lokale, mediat;

PROGRAMI I MASAVE FITOSANITARE: krijimi dhe funksionimi i një sistemi efektiv të mbrojtjes së shëndetit të bimëve; zbatimin e mbikëqyrjes së organizmave të dëmshëm, përcaktimin e statusit të tyre, parandalimin e futjes dhe përhapjes së organizmave të dëmshëm dhe çrrënjosjen e tyre, zbatimin e planeve të krizës dhe veprimit për organizma të caktuar të dëmshëm; sigurimi i një sasive të mjaftueshme të ushqimit të sigurt me bazë bimore; prodhimi i farës dhe materialit fidanor cilësor, duke përfshirë monitorimin e OMGJ; ruajtja e burimeve gjenetike bimore.

FONDI I INVESTIMEVE DHE ZHVILLIMIT I MALIT TË ZI (FIZH) u themelua në vitin 2009. Qëllimi i themelimit është të inkurajojë dhe përshpejtojë zhvillimin ekonomik të Malit të Zi. Veprimtaria e Fondit përcaktohet nëpërmjet miratimit të kredive dhe dhënies së garancive, kryerjes së veprimtarive që lidhen me shitjen e kapitalit, si dhe kryerjes së veprimtarive të tjera që ofrojnë mbështetje për zhvillimin ekonomik. Fondi gjithashtu ndan mjete për zhvillimin e bujqësisë dhe këto programe janë aktuale:

- Programi mbështetës për bujqësinë dhe prodhimin e ushqimit. Kreditë janë të dedikuara për investime në asete fikse - aktive të prekshme (objekte ndërtimi, pajisje dhe makina, kope bazë, rritje të mbjelljeve afatgjata, inventar i vogël...), aktive jo-materiale (zhvillimi i produktit ose shërbimit, patentat, licencat, koncesionet, të drejtat e autorit , franshiza...) dhe kapitali qarkullues. Përfitues të kredive mund të jenë kompanitë dhe sipërmarrësit dhe të gjitha format e organizimit të parapara me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, si dhe personat të cilët veprimtarinë e tyre e kryejnë në mënyrë të përcaktuar me rregullat e veprimtarisë me të cilat merren (prodhuesit bujqësorë, etj.);
